

KAPAKU

FRANK KARSTEN & KAREL BECKMAN

PËRTEJ DEMOKRACISË

PSE DEMOKRACIA NUK ÇON NË SOLIDARITET, PROSPERITET E LIRI, POR NË KONFLIKTE SOCIALE, SHPENZIME PA FRE E QEVERI TIRANIKE.

“Ky libër ka një fuqi shpjeguese të pamasë. Mund të të çlirojë mendjen.” – Jeffrey Tucker, redaktor ekzekutiv i Botimeve Laissez Faire.

PËRMBAJTJA:

HYRJE:

Demokracia – Tabuja e fundit – fq.7

Besimi demokratik – fq.8

Demokracia = Kolektivizëm – fq.10

1. Mitet e Demokracisë

Miti 1 - Çdo votë ka rëndësi – fq.14

Miti 2 – Populli sundon në demokraci – fq.17

Miti 3 – Maxhoranca ka të drejtë – fq.21

Miti 4 – Demokracia është politikisht neutrale – fq.23

Miti 5 – Demokracia çon në prosperitet – fq.30

Miti 6 – Demokracia është e nevojshme për të siguruar një ndarje të ndershme të pasurisë dhe ndihmës ndaj të varfërve – fq.36

Miti 7 – Demokracia është e nevojshme për të jetuar së bashku në harmoni – fq.40

Miti 8 – Demokracia është e domosdoshme në komunitet – fq.46

Miti 9 – Demokraci do të thotë liri e tolerancë – fq.49

Miti 10 – Demokracia promovon paqe dhe ndihmon në luftën ndaj korrupsionit – fq.55

Miti 11 – Njerëzit marrin atë që duan në demokraci – fq.59

Miti 12 – Ne jemi të gjithë demokratë – fq.64

Miti 13 – Nuk ka alternativë (më të mirë)- fq.67

2. Kriza e Demokracisë – fq.70

Mëkatet e demokracisë – fq.71

Pse gjithçka po përkeqësohet? – fq.76

Pse na duhet më pak demokraci?- fq.78

3. Drejt një lirie të re – fq.80

Decentralizimi dhe liritë individuale – fq.81

Një treg për qeverisjen – fq.82

Decentralizimi në Zvicër – fq.84

Shoqëria kontraktuese – fq.87

Rruga drejt lirisë – fq.89

Një e ardhme e ndritur – fq.92

Pasthënie – *Libertarianizmi dhe demokracia - fq.96*

Thënie – fq.100

HYRJJE

DEMOKRACIA – TABUJA E FUNDIT

“ Nëse ka të këqija nga te cilat demokracia vuan sot, ato mund të shërohen vetëm me më tepër demokraci”.

Kjo thënie e vjetër nga një politikan amerikan tregon në esencë se si konsiderohet përgjithësisht sistemi ynë politik demokratik. Njerëzit janë të përgatitur të dakortësojnë se demokracia mund të ketë problemet e veta – madje shkojnë edhe më tej, se shumë demokraci parlamentare perëndimore, përfshirë atë të ShBA-ve, mund të jenë në prag të rrënimit – por nuk mund të japin dot alternativë. E vetmja gjë që sugjerojnë është të kesh më tepër demokraci.

Që sistemi ynë demokratik parlamentar është në krizë, pak vetë mund ta mohojnë. Kudo, shtetasit e vendeve demokratike janë të pakënaqur e të përçarë. politikanët ankohen se votuesit sillen si fëmijë të llastuar, ndërkohë që shtetasit ankohen se politikanët bëjnë shurdhin ndaj kërkesave të tyre. Votuesit janë bërë të paqëndrueshëm. Ata kalojnë sa nga njëra aleancë politike, tek tjetra. Ata gjithashtu tërhiqen jashtëzakonisht nga partitë radikale apo populiste. Kudo peizazhi politik është bërë fragmentar, duke e vështirësuar më tepër kapërcimin e vështirësive dhe formimin e qeverive frytdhënëse.

Partitë politike ekzistuese nuk kanë një përgjigje ndaj këtyre sfidave, nuk janë në gjendje të zhvillojnë alternativa reale. Ato kanë ngecur brenda strukturave të ngurta partiake, idealet e të cilave janë rrëmbyer nga grupe apo lobingje të veçantë interesi. Virtualisht, asnjë qeveri demokratike nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë shpenzimet e veta. Shumica e tyre kanë marrë hua, harxhuar dhe taksuar intensivisht, sa që kanë rezultuar në kriza financiare të cilat i kanë çuar shumë vende në prag falimentimi. Edhe në ato raste të rralla kur kushtet i detyrojnë qeveritë të shkurtojnë shpenzimet të paktën përkohësisht, elektorati ngrihet në protesta për atë çka ata besojnë se është një sulm ndaj drejtuesve të shtetit, duke bërë të pamundur çdo lloj shkurtimi të mundshëm.

Pavarësisht shpenzimeve pa fre, pothuajse të gjitha vendet demokratike vuajnë nga shkalla e lartë e përhershme e papunësisë. Grupe të mëdhenj njerëzish mbeten në

prapaskenë. Virtualisht, asnjë vend demokratik nuk ka hartuar dispozita adekuate për popullsinë e moshuar.

Në mënyrë tipike, të gjitha vendet demokratike vuajnë nga eksesi burokratik dhe përkushtimi rregullator. Tentakulat e shtetit arrijnë jetën e gjithkujt. Ka rregulla e rregullore për gjithçka që shohim në dritën e diellit. Dhe secilit problem i adresohet me më tepër rregulla se sa me zgjidhjen e vërtetë.

- “ *Nuk ekzagjerohet kur thuhet se demokracia është kthyer në fe – një fe moderne, laike*”.

Në të njëjtën kohë, qeveritë demokratike punojnë keq në lidhje me atë që shumica e njerëzve e quajnë punën më të rëndësishme – vendosjen e ligjit dhe rendit. vandalizmi dhe krimet janë shtuar. Policia dhe sistemi i drejtësisë janë bërë të pabesueshëm, jo kompetentë dhe shpesh të korruptuar. Kriminalizohen raste të sjelljes së padëmshme më tepër. Në bazë të përqindjes së popullsisë, ShBA-të kanë numrin më të madh të të burgosurve në botë. Shumë prej tyre janë në burg për sjellje të parrezikshme, thjesht sepse zakonet e tyre konsiderohen ofenduese nga maxhoranca.

Besimi i njerëzve tek politikanët e zgjedhur demokratikisht është ulur ndjeshëm, sipas studimeve të ndryshme. Ka një mosbesim të thellë ndaj qeverive, sunduesve politikë, elitave apo agjencive ndërkombëtare që duket se e vendosin veten mbi ligjin. Shumë njerëz janë bërë pesimistë për të ardhmen, i tremben faktit se fëmijët e tyre do jenë më keq se ata vetë. I frikësohen një invazioni emigrantësh; shqetësohen për kërcënimet me të cilat përballet kultura e tyre dhe jetojnë me nostalgjinë e kohëve të shkuara.

BESIMI DEMOKRATIK

Megjithëse kriza demokratike është e përligjur tashmë, virtualisht nuk ka kritika ndaj vetë sistemit demokratik. Asnjë nuk fajëson demokracinë në lidhje me problemet me të cilat po përballemi. Politikanë nga të gjitha drejtimet, - të majtë, të djathtë apo në mes, - pretendojnë se do i trajtojnë problemet me më tepër demokraci, se do i dëgjojnë njerëzit dhe se do e vënë interesin publik mbi atë privat. Pretendojnë gjithashtu se do shkurtojnë burokracinë, do bëhen më transparentë, se do sigurojnë shërbime më të mira – që ta bëjnë sistemin të funksionojë përsëri. Por ata kurrë nuk e vënë në pikëpyetje sistemin demokratik. Argumentojnë se problemet tona shkaktohen nga liria e tepërt apo demokracia me shumicë. I vetmi dallim mes progresistëve dhe konservatorëve është se të parët ka gjasa të ankohen për liri ekonomike me tepëri, ndërsa të dytët për liri sociale me tepëri. Kjo gjë, ndërkohë që kurrë më parë nuk ka pasur kaq shumë ligje e kaq shumë taksa të larta.

Në fakt, kritikantët ndaj ideve demokratike janë kthyer në tabu në vendet perëndimore. Je i lejuar të kritikosh faktin se si po zbatohet demokracia apo liderët aktualë politikë – por jo vetë demokracinë.

Nuk ekzagjerohet kur thuhet se demokracia është shndërruar në fe – një fe moderne laike. Mund ta quajmë besimin më të madh mbi tokë. Vetëm njëmbëdhjetë vendeve, – Majnmar, Suajzlend, Vatikani dhe disa vende arabe – pretendojnë se janë demokraci, pavarësisht se vetëm emrin kanë të tillë. Besimi në Zotin e demokracisë lidhet ngushtë me adhurimin e shtetit kombëtar demokratik të krijuar gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë. Zoti dhe Kisha u zëvendësuan me Shtetin si shoqëria e Atit të Shenjtë. Zgjedhjet demokratike janë rituali me të cilin ne i lutemi shtetit për punësim, strehim, kujdes shëndetësor, siguri, edukim. Kemi besim absolut tek Shteti Demokratik, besojmë se ai mund të kujdeset për gjithçka – se ai është shpërblyesi, gjykatësi, ai që i di të gjitha, i plotfuqishmi. Madje presim prej tij edhe që të na zgjidhë gjithë problemet sociale apo personale.

E mira e *Zotit Demokraci* është se ai na siguron punën e tij tërësisht pa përfitim. Si edhe vetë Zoti, Shteti nuk ka interes personal, është gardiani i interesit publik, nuk kushton gjë, dhe na jep falas bukën apo favore të tjera.

Të paktën, kështu ju duket njerëzve. Shumica prej tyre priren të shohin vetëm përfitimet që jep qeveria, jo kostot. Një arsye për këtë është se qeveria grumbullon taksa në shumë mënyra indirekte; p.sh. duke ju kërkuar bizneseve të mbledhin taksa mbi shitjet, apo punëdhënësve taksat e sigurimeve shoqërore, ose duke marrë hua në tregjet financiare (që një ditë do paguhen nga taksapaguesit), ose duke inflacuar paranë, që njerëzit të mos e dinë se sa të ardhura janë konfiskuar nga qeveria. Një arsye tjetër është se rezultatet e veprimeve të qeverisë janë të dukshme dhe të prekshme, por gjithë gjërat që mund dhe duheshin bërë nëse qeveria nuk do kishte konfiskuar paratë e njerëzve që në fillim, mbeten të padukshme. Avionët e luftës që ndërtohen janë aty për t'i parë të gjithë, por gjithë ato gjëra që nuk mund të kryhen sepse paraja publike u shpenzua për ato avionë lufte, mbeten të padukshme.

Besimi demokratik është bërë kaq i thellë sa demokracia për shumë njerëz është sinonim i gjithçkaje që është (politikisht) e drejtë dhe morale. Demokraci do të thotë liri (çdo njeri lejohet të votojë); barazia (çdo votë numërohet njësoj), drejtësia (çdo njeri është i barabartë), bashkimi (të gjithë vendosim bashkërisht), paqja (demokracia kurrë nuk bën luftë të padrejtë). Në këtë mënyrë mendimi, e vetmja alternativë ndaj demokracisë është diktatura. Dhe diktatura, sigurisht, përfaqëson gjithçka të keqe: mungesë lirie, pabarazi dhe padrejtësi.

Në esenë e tij të famshme në vitin 1989 “Fundit i historisë?”, mendimtari neo-konservator Francis Fukuyama shkoi aq larg sa deklaroi se sistemi demokratik modern perëndimor është maja e evolucionit politik të njerëzimit. Ose, siç e thotë ai vetë, sot po dëshmojmë “universalizimin e demokracisë liberale perëndimore si formën finale të qeverisë njerëzore”. Dihet se vetëm mendjet e këqija (terroristët, fundamentalistët, fashistët) do guxonin të flisnin kaq hapur kundër një nocioni kaq të shenjtë.

DEMOKRACIA = KOLEKTIVIZËM

Kjo është ajo çfarë do bëjmë në këtë libër: do ngremë zërin kundër Zotit të demokracisë, veçanërisht kundër demokracisë parlamentare kombëtare.

Modeli vendimmarrës demokratik është i dobishëm në disa kontekste, në komunitete të vogla apo brenda shoqatave. Por një demokraci kombëtare parlamentare, që e kanë pothuajse të gjitha vendet perëndimore, ka më tepër të meta se sa avantazhe. Demokracia parlamentare sipas nesh, është e padrejtë, na çon drejt burokracisë dhe stanjacionit, minon lirinë, pavarësinë dhe sipërmarrjen dhe në mënyrë të pashmangshme të çon në antagonizëm, ndërhyrje, letargji dhe mbi shpenzime. Dhe jo sepse politikanë të caktuar dështojnë në punën e tyre – apo sepse drejton jo partia e duhur – por sepse kështu funksionon sistemi.

Shenja dalluese i demokracisë është se “njerëzit” vendosin mbi organizimin e shoqërisë. Me fjalë të tjera, të gjithë ne “së bashku” vendosim mbi gjithçka që na preokupon. Sa taksa të larta duhet të kemi, sa para duhen shpenzuar për kujdesin ndaj fëmijëve apo të moshuarve, në çfarë moshe janë të lejuar njerëzit të pinë alkool, sa para duhet të paguajnë punëdhënësit për pensionet e punonjësve të tyre, çfarë duhet të vendoset mbi etiketën e një produkti, se çfarë të mësojnë fëmijët në shkollë, se sa para duhen harxhuar nëpërmjet ndihmës për zhvillim ose energjisë së rinovuar, apo për edukimin sportiv e muzikor, se si duhet ta ndërtojë barin e vet një pronar lokali dhe nëse klientët e tij janë të lejuar të pinë duhan aty brenda, se si të ndërtohet një shtëpi, se sa duhet të jetë shkalla e interesit, sa para duhet të qarkullojë në ekonomi, nëse bankat duhen shpëtuar me paratë e taksapaguesve nëse kërcënohen prej falimentimit, kujt i lejohet ta quajë veten mjek apo të hapë një spital, nëse njerëzit janë të lejuar të vdesin kur janë lodhur me jetën dhe nëse apo kur një vend do hyjë në luftë. Në demokraci, pritet që “njerëzit” të vendosin mbi këto probleme e mbi shumë të tjera si këto.

Pra, demokracia është përcaktuar si sistem kolektiv, është socializëm nga dera e pasme. Ideja bazë pas saj se është e dëshirueshme dhe e drejtë që të gjitha vendimet e rëndësishme rreth organizimit fizik, social dhe ekonomik të shoqërisë merren në kolektiv nga populli. Dhe pastaj populli autorizon përfaqësuesit e vet në parlament – me fjalë të tjera, Shtetin – t’i marrë këto vendime për ta. Në demokraci e gjithë struktura e shtetit përshtatet drejt shtetit.

Qartësisht është gabim të pretendosh se demokracia është, deri diku maja e pashmangshme e evolucionit politik të njerëzimit. Kjo është thjesht propagandë për të fshehur atë që vërtetë demokracia përfaqëson, një orientim të caktuar politik. Për këtë ka vërtetë shumë alternativa të arsyeshme.

Njëra nga këto alternativa quhet: Liria. Ose Liberalizmi – në sensin klasik të fjalës (që ka tërësisht një tjetër kuptim nga fjala liberalizëm e përdorur sot në ShBA).

Nuk është e vështirë të dallosh ndryshimin mes Lirisë dhe demokracisë. Duhet marrë kjo gjë në konsideratë: A vendosim ne demokratikisht se sa para të harxhojmë për veshjet? Apo se në cilin supermarket të shkojmë? Sigurisht që jo. Secili vendos për veten. Dhe kjo liri e të zgjedhurit funksionon shkëlqyeshëm. Pra, pse të funksionojë më mirë kur të gjitha gjërat që ndikojnë mbi ne - vendi i punës, kujdesi shëndetësor dhe pensionet, klubet dhe pabet, të vendosen demokratikisht?

Në fakt, a nuk duhet të jetë rasti që ky fakt – pra që ne vendosim mbi gjithçka demokratikisht, që virtualisht të gjitha çështjet ekonomike e sociale kontrollohen nga apo nëpërmjet shtetit – është shkaku kryesor i gjithçkaje që shkon keq në shoqërinë tonë? Që burokracia, parazitizmi, krimi, korrupsioni, papunësia, inflacioni, standardet e ulëta të edukimit etj., nuk janë për shkak të mungesës së demokracisë, por janë të shkaktuara prej demokracisë?

Këtë shpresojmë t’ju tregojmë nëpërmjet këtij libri.

Ky libër është i ndarë në tri pjesë. Në të parën diskutojmë në lidhje me besimin tonë tek Zoti i demokracisë parlamentare. Si çdo fe, demokracia ka një set besimesh – dogmash që i pranojnë të gjithë si të vërteta të padiskutueshme. Ne i paraqesim këto në formën e 13 miteve popullore të demokracisë.

Në pjesën e dytë, përshkruajmë pasojat praktike te sistemit demokratik. përpiqemi të tregojmë pse demokracia të shpie pashmangshmërisht në stanjacion dhe çfarë e bën atë të pamjaftueshme dhe të padrejtë.

Në pjesën e tretë paraqesim një alternativë të demokracisë, kryesisht një sistem të bazuar mbi vetë-vendosmërinë e individit, që karakterizohet nga decentralizimi, qeverisja lokale dhe diversiteti.

Pavarësisht kritikave tona ndaj sistemit aktual kombëtar demokratik, ne jemi optimistë për të ardhmen. Një arsye pse shumë njerëz sot ndjehen pesimistë është se e ndjejnë që sistemi aktual nuk po shkon askund, por ata nuk mund të imagjinojnë një alternativë tërheqëse. E dinë se qeveria ju kontrollon jetën në shkallë të gjera, ndërkohë që ata vetë s’e kontrollojnë dot qeverinë. Alternativat që ata mund të imagjinojnë janë forma diktaturash, si p.sh. “modeli kinez” apo ndonjë formë tjetër nacionalizmi apo fundamentalizmi.

Por këtu gabohen. Demokraci nuk do të thotë Liri. Edhe ajo është një formë diktature – diktaturë e maxhorancës dhe e Shtetit. Nuk mund të ketë sinonim dot as me drejtësinë, barazinë, solidaritetin apo paqen.

Demokracia është një sistem që u prezantua 150 vjet më parë në shumë vende perëndimore, për arsye të ndryshme – për së pari që të arriheshin idetë socialiste brenda shoqërive liberale. Pavarësisht arsyeve të asaj kohe, tani nuk kemi më ndonjë arsye të mirë për ta ruajtur demokracinë kombëtare parlamentare. Ajo nuk funksionon më. Ka ardhur koha për një liri të re, në të cilën produktiviteti dhe solidariteti nuk janë të organizuara mbi bazën e diktaturës demokratike, por janë rezultat i marrëdhënieve vullnetare mes njerëzve. Shpresojmë t’i bindim lexuesit se mundësia e realizimit të këtij ideali është më e madhe se sa shumë njerëz e besojnë – dhe se ja vlen ta ndjekësh.

1. MITET E DEMOKRACISË

MITI 1 - ÇDO VOTË VLEN

E dëgjojmë vazhdimisht këtë frazë gjatë zgjedhjeve elektorale - Pretendimin se vota juaj vlen vërtetë. Gjë që është e vërtetë – për një në njëqind milion (nëse flasim për zgjedhjet presidenciale në ShBA). Por nëse keni një në njëqind milion influencë në rezultatit e

procesit, ose 0.000001%, në praktikë kjo është zero influencë. Shansi që vota juaj do përcaktojë se kush do i fitojë zgjedhjet është astronomikisht i vogël.

Dhe aktualisht është më keq, sepse vota që hidhni nuk është për një politikë apo vendim specifik. Ajo është votë për një kandidat ose parti politike që do marrë vendime në emrin tuaj. Por ju s'keni asnjë influencë në vendimet që mund të marrin personat apo partitë, ju s'mund t'i kontrolloni ata. Për katër vjet, ata mund të vendosin çfarë të duan dhe ju s'bëni dot asgjë. Mund t'i bombardoni me e-maile, mund t'ju bini në gjunjë apo t'i mallkoni, por ata vendosin.

çdo vit qeveria merr me qindra vendime. Vota juaj për atë që bën çfarë dëshiron, pa u konsultuar me zgjedhësit, nuk ka asnjë shtysë të matshme mbi ndonjë vendim.

Vota që ju hidhni zakonisht madje nuk është as zgjedhje e vërtetë. Më tepër është tregues i një preference të vagët. Rrallë ka ndonjë person apo parti politike me të cilët të bini dakord në gjithçka. Supozojmë se nuk doni që paratë të harxhohen për ndihma ndaj vendeve të Botës së Tretë apo për luftën në Afganistan. Ku mund të votoni për një parti që është kundër kësaj. Por mbase kjo parti është pro rritjes së moshës së pensionit, gjë që ju e kundërshtoni.

Për më tepër, pasi personi apo partia për të cilën votuat është zgjedhur, ndodh shpesh që t'i shkulin premtimet e dhëna para zgjedhjeve. çfarë mund të bëni ju? Duhej t'i padisnit për mashtrim, por s'mundeni. Më e mira që mund të bëni është që të votoni për dikë tjetër pas katër viteve, por edhe kjo nuk sjell shumë rezultat.

Votimi është iluzioni i influencës në shkëmbim të humbjes së lirisë. Kur Tomi ose Xhejni shkojnë para kutisë së votimit, ata mendojnë se po influencojnë mbi drejtimin që do të marrë vendi. Në një shkallë shumë të vogël kjo është e vërtetë. Në të njëjtën kohë, 99.9999% e votuesve vendosin mbi drejtimin që do marrë jeta e Tomit apo e Xhejnit. Në këtë mënyrë ata humbasin shumë më tepër kontroll mbi jetët e tyre, se sa fitojnë në influencën mbi jetët e të tjerëve. Do të kishin shumë më tepër "influcencë" nëse do bënin zgjedhjen e tyre. Për shembull, nëse do vendosnin për veten se si t'i shpenzonin paratë, pa ja paguar që në fillim gjysmën e të ardhurave qeverisë përmes taksave të ndryshme.

Të japim një shembull tjetër. Në sistemin tonë demokratik, njerëzit kanë pak kontroll mbi edukimin e fëmijëve të tyre. Nëse duan të ndryshojnë praktikën edukative, pra nëse duan të kenë më tepër influencë se para kutisë së votimit, duhet të bashkohen që të krijojnë një grup lotues, apo të paraqesin para politikanëve peticione, apo të organizojnë protesta para ndërtesave qeveritare. Ka disa organizata prindërisht që përpiqen të influencojnë mbi politikën edukative në këtë mënyrë. Duhet shumë kohë dhe energji dhe nuk ka ndonjë efekt. Do ishte më e thjeshtë e më efikase nëse shteti nuk do ndërhynte në edukim, ndërkohë që mësuesit, prindërit dhe studentët mund të bënin zgjedhjen e tyre, së bashku dhe individualisht.

Sigurisht, klasa sunduese vazhdimisht i shtyn njerëzit të votojnë. Ata gjithmonë theksojnë se duke votuar, njerëzit do kenë influencë mbi politikën qeveritare. Por ajo që vërtetë ju intereson është se rezultati i thellë do ju japë vulën aprovue mbi gjithçka, një e drejtë morale për të sunduar mbi popullin.

Shumë njerëz besojnë se është detyrë morale të marrësh pjesë në zgjedhje. Thuhet shpesh se, nëse nuk voton, nuk ke të drejtë të ngresh zërin në debate publike ose të ankohesh për vendime politike. Por ju nuk e hodhët votën që opinionin tuaj të mos llogaritet më. Njerëzit që e pretendojnë këtë gjë, me siguri nuk mund të imagjinojnë se ka disa njerëz që refuzojnë të abonohen tek iluzioni i influencës që shet demokracia. Ata vuajnë nga

sindroma e Stokholmit, i duan rrëmbyesit e tyre dhe nuk e kuptojnë se po tregtojnë autonominë e tyre për pushtetin që politikanët dhe administratorët ushtrojnë mbi ta.

MITI 2 - NË DEMOKRACI SUNDON POPULLI

Kjo është ideja bazë e demokracisë, ajo çfarë do të thotë fjalë për fjalë “demokraci”, pra sundimi i popullit. Por, a sundojnë vërtetë njerëzit në një demokraci?

Problemi i parë është se “populli” nuk ekziston. Ka miliona individë, me po aq opinione dhe interesa. Si mund të qeverisin ata së bashku? Kjo është e pamundur. Siç e ka thënë njëherë një komedian holandez: “demokracia është vullneti i njerëzve. çdo mëngjes, habitem kur lexoj në gazetë atë që dua”.

Le të përballemi me këtë. Askush nuk thotë gjëra si p.sh. “konsumatori do Microsoft” ose “njerëzit duan Pepsi”. Disa i duan e disa jo. E njëjta gjë zbatohet edhe për preferencat politike.

Plus kësaj, nuk është vërtetë “populli” që vendos në një demokraci., por “maxhoranca” e popullit, ose më mirë maxhoranca e votuesve. Siç duket, minoranca nuk i përket “popullit”. Kjo duket pak e habitshme. A nuk është gjithsecili pjesë e “popullit”? Si konsumator i WalMart-it, ju nuk dëshironi që ushqimet e një supermarketi tjetër t’ju shtyhen me forcë në gurmaz, por kështu funksionojnë gjërat në demokraci. Nëse ndodh që t’i përkasësh palës humbëse, duhet të heqësh vallen me fituesit.

Por, në rregull, le të supozojmë se “shumica” është njësoj me “popullin”. A është e vërtetë që populli vendos? Ta shohim. Ka dy tip demokracish: direkt dhe indirekt (ose përfaqësuese). Në një demokraci direkt, gjithsecili voton mbi çdo vendim të marrë, si në një referendum. Në një demokraci indirekte, njerëzit votojnë për të tjerët, të cilët më pas marrin vendime në emër të popullit. Duket qartë se në rastin e dytë njerëzit kanë shumë më pak për të thënë se sa në të parin. Megjithatë, të gjitha demokracitë moderne janë indirekte, megjithëse mund të mbajnë referendume me raste.

Për të justifikuar sistemin përfaqësues, argumentohet se: a) do ishte jo praktike të mbahej një referendum për të gjitha vendimet që qeveria merr çdo ditë, dhe b) njerëzit nuk kanë ekspertizë të mjaftueshme për të vendosur mbi të gjitha llojet e çështjeve komplekse.

Argumenti a) mund të jetë duartrokatur në të shkuarën, sepse ishte vështirë t’i siguroje gjithkujt informacionin e nevojshëm e t’i lejoje të shprehnin opinionin e tyre, përveç se në komunitete të vogla. Sot ky argument nuk vlen. Me internetin dhe teknologjitë e tjera moderne komunikuese, është e lehtë të lejosh një grup të madh njerëzish të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse e të mbajnë referendume. Megjithatë, kjo gjë pothuajse nuk ndodh kurrë. Pse të mos mbahet referendum për faktin nëse ShBA duhet të përfshihet në luftën në Afganistan apo Libi apo kudo qoftë? Mbi të gjitha, është populli që sundon, apo jo? Pse të mos i marrin njerëzit këto vendime që janë thelbësore për jetët e tyre? Në fakt, sigurisht, të gjithë e dinë se ka shumë vendime të marra që maxhoranca nuk do mbështeste, nëse do hidheshin në votë. Pra, ideja që populli “sundon” është thjesht një mit.

Po argumenti b)? A nuk janë shumë çështje tepër komplekse për tu hedhur në votë? Vështirë. Nëse një xhami duhet të ndërtohet diku, se cila duhet të jetë mosha ligjore për të

pirë alkool, se sa duhet të jetë dënimi minimal për krime të caktuara, nëse më pak ose më shumë autostrada duhen ndërtuar, se sa i lartë duhet të jetë borxhi kombëtar, ose nëse një shtet duhet të pushtohet, e kështu me radhë – këto janë të gjitha propozime shumë të qarta. Nëse sunduesit tanë do e merrnin demokracinë seriozisht, a nuk do i lejonin njerëzit të votonin direkt për një sërë çështjesh?

Po argumenti b) mos do të thotë se njerëzit nuk janë aq inteligjentë sa për të dhënë opinione të arsyeshme mbi probleme ekonomike apo sociale? Nëse kjo është e vërtetë, atëherë si do mund të arrijnë të kuptojnë programet e ndryshme elektorale e të votojnë mbi bazën e tyre? Gjithkush që mbështet demokracinë duhet, të paktën, të supozojë se njerëzit i dinë nja dy gjëra dhe janë në gjendje ta kuptojnë gjuhën e qartë. Përveç kësaj, pse duhet që politikanët të jenë më të zgjuar se votuesit që i zgjedhin ata? Mos kanë ndonjë leje të mistershëm ndaj burimit të urtësisë dhe dijeve, ndërkohë që votuesit jo? Apo kanë vlera morale më të larta se një qytetar mesatar? Nuk ka asnjë fakt që ta provojë këtë.

Mbështetësit e demokracisë mbase do debatojnë me faktin që, ndonëse njerëzit nuk janë budallenj, asnjë prej tyre nuk ka njohuri dhe inteligjencë të mjaftueshme për të marrë vendime mbi probleme komplekse që ndikojnë thellësisht në jetët e milionave individëve. Kjo është pa dyshim e vërtetë, por e njëjta gjë ndodh me politikanët dhe punonjësit civilë, të cilët marrin vendimet në demokraci. Për shembull, nga e dinë ata se çfarë lloj edukimi kërkojnë prindërit, mësuesit dhe studentët? Apo se cili edukim është më i miri? Njerëzit kanë shumë dëshira dhe pikëpamjet e tyre mbi edukimin e mirë. Shumë prej tyre janë inteligjentë mjaftueshëm për të vendosur për veten dhe fëmijët. Por kjo bie ndesh me qëndrimin e centralizuar “një masë për të gjithë” të demokracisë.

Duket qartë se në demokracitë tona nuk janë njerëzit që sundojnë. Dhe kjo nuk është habi. të gjithë e dinë se qeveritë rregullisht marrin vendime që shumica e njerëzve i kundërshtojnë. Nuk është “vullneti i popullit”, por dëshira e politikanëve – të mbështetur nga grupe lobistësh, interesash apo aktivistësh – që sundojnë në demokraci.

Big Oil, Big Agra, Big Pharma, Big Medicine, Military-industrial Complex, Wall Street – të gjithë e dinë mirë si ta kthejnë sistemin në avantazh të tyre. Një elitë e vogël merr vendime, shpesh mbrapa skene. Nuk e vrasin mendjen për atë që do populli, i harxhojnë kursimet e njerëzve për luftëra dhe programe ndihme, lejojnë emigrimin në masë, krijojnë deficite të mëdha, përgjojnë shtetas, ndezin luftëra, i harxhojnë paratë tona për subvencione grupesh të veçantë, hyjnë në marrëveshje – si p.sh. bashkimi monetar në BE apo Nafta – që kanë përfitim jo produktiv në kurriz të produktivitetit. E duam ne këtë gjë demokratikisht apo janë sunduesit tanë ata që e kërkojnë?

Sa njerëz vullnetarisht do të transferonin mijëra dollarë në llogaritë bankare të qeverisë, që ushtarët të luftojnë në Afganistan në emër të tyre? Pse të mos pyetet populli një herë të vetme? A është ai që sundon?

Shpesh thuhet se demokracia është një mënyrë e mirë për të kufizuar pushtetin e sunduesve, por tashmë e kuptojmë se ky është një tjetër mit i krijuar. Sunduesit bëjnë përherë atë që duan.

Për më tepër, pushteti i politikanëve zgjerohet më shumë se sa veprimet e tyre në parlament apo qeveri. Kur ata nuk zgjidhen më nga votuesit, shpesh gjejnë vende të rehatshme e të lakmuara brenda organizatave që ekzistojnë në simbiozë të ngushtë me shtetin – kompani televizive, unione pune, shoqëri strehimesh, universitete, OJQ, grupe lotimi, Think Tanks dhe mijëra firma avokatie që jetojnë në ShBA si myku në një trung

peme të kalbur. Me fjalë të tjera, një ndryshim në qeveri nuk do të thotë domosdoshmërisht ndryshim në mbajtje pushteti. Përgjegjësia demokratike është më e kufizuar seç duket.

Ja vlen gjithashtu të përmendet se është tepër e thjeshtë të marrësh pjesë në zgjedhje në ShBA. Për tu lejuar të vësh kandidaturë në zgjedhjet federale, duhet të jesh në përputhje me legjislacionin që përmban 500 faqe. Rregullat janë kaq komplekse sa që nuk mund të kuptohen nga profanët.

Pavarësisht kësaj, mbështetësit e demokracisë përherë këmbëngulin se “ne votuam për këtë”, kur qeveria zbaton ligje të reja. Kjo nënkupton se “ne” nuk kemi më të drejtë ta kundërshtojmë një masë të tillë. Por ky argument rrallë përdoret në mënyrë konsistente. Homoseksualët e përdorin për të mbrojtur të drejtat e tyre., por nuk e pranojnë kur një vend demokratik e ndalon homoseksualitetin. Aktivistët ambientalistë kërkojnë që masat ambientaliste të marra demokratikisht janë të detyruara, por ndjehen të lirë për të organizuar protesta jo të ligjshme nëpër rrugë, nëse nuk bien dakord me vendimet demokratike. në këto raste, duket qartë se “ne” nuk votuam për të.

MITI 3 - MAXHORANCA KA TË DREJTË

Le të supozojmë për një çast, për hir të argumentit, se populli vërtet qeveris në një demokraci se çdo votë ka rëndësi. Por a do të jetë rezultati i këtij procesi automatikisht i mirë apo korrekt? Në fakt, ndaj e kemi demokracinë, që të bëjmë gjërat e duhura. Por është vështirë të shohësh se pse ose si procesi demokratik domosdoshmërisht do të çojë drejt rezultateve të mira. Nëse shumë njerëz besojnë në diçka, kjo gjë nuk e bën atë të vërtetë. Ka plot shembuj në të shkuarën në lidhje me zhgënjimet kolektive. Për shembull, njerëzit më parë mendonin se kafshët nuk përjetojnë dhimbje, ose që toka nuk qe e rrumbullakët, ose që mbretërit apo sunduesit ishin përfaqësuesit e Zotit në tokë.

Pra, diçka nuk mund të jetë e drejtë ose e ndershme vetëm se njerëzit janë pro saj. Mendoni pak për krimet kolektive të kryera nga njerëzit në të shkuarën. Skllavëria apo persekutimi i hebrenjve në atë kohë u pranuan nga një pjesë e njerëzve.

Përgjithësisht, njerëzit udhëhiqen nga vet-interesi kur ata votojnë. Votojnë për partitë, nga të cilat presin përfitime personale. E dinë se kostoja që vjen nga përfitimi paguhet prej të gjithëve. A është kjo gjë e drejtë apo e dëshirueshme? E vërteta e sikletshme është se njerëzit janë të prirur të jenë pro demokracisë sepse shpresojnë ose presin që t'i përkasin maxhorancës, kështu të mund të përfitojnë duke i plaçkitur pasurinë e pjesës tjetër. Shpresojnë që barra e tyre do mbahet prej të tjerëve dhe po ashtu përfitimet do paguhen prej të tjerëve. Kjo gjë është e kundërta e sjelljes morale.

Mos po e ekzagjerojmë pak? Nëse ju dhe miqtë tuaj vjedhin dikë në rrugë, do të dënoheni. Nëse maxhoranca aprovon një ligj për të vjedhur minorancën (një taksë të re mbi alkoolin apo duhanin, për shembull), ky konsiderohet si vendim demokratik, pra i ligjshëm. Por cili është ndryshimi nga vjedhja në rrugë?

Kur e mendon, nxjerr përfundimin se mekanizmi bazë i demokracisë është krejtësisht imoral. Në demokraci konsideratat morale janë sajuar nga vullneti i maxhorancës. Sasia ia hedh cilësisë – numri i njerëzve që duan diçka nuk përfill konsideratat e moralit dhe nacionalitetit.

Politikani dhe shkrimtari britanik i shekullit të 19-të Auberon Herbert, ka thënë rreth logjikës dhe moralit të demokracisë:

“Pesë njerëz janë në një dhomë. Tre prej tyre mbështesin njëren pikëpamje dhe dy pikëpamjen tjetër. Por a kanë të drejtë të parët të detyrojnë dy të tjerët që të mbështesin të njëjtën? Çfarë forcë magjike vjen mbi këta të tre? Meqë janë një më shumë në numër, bëhen papritur pronarë të mendjes dhe trupit të dy të tjerëve. Po nëse do ishin dy me dy? Njeriu duhet të mbetet zot i mendjes dhe trupit të vet, përndryshe nuk do ketë asnjë ndryshim nga supersticionet e lashta rreth perandorëve dhe priftërinjve të lartë, të cilët ushtronin autoritet suprem mbi shpirtin dhe trupin e njeriut.”

MITI 4 - DEMOKRACIA ËSHTË POLITIKISHT NEUTRALE

Demokracia është e ngjashme me çdo drejtim politik. Votuesit përcaktojnë preferencat politike të partive në pushtet. Kështu, vetë sistemi tejkalon gjithë dallimet në këndvështrimin politik.: në vetvete nuk është as i majtë, as i djathtë, socialist apo kapitalist, konservator apo progresist.

Kështu duket, të paktën. Por kjo është vetëm gjysma e së vërtetës. në realitet, demokracia mishëron një drejtim specifik politik.

Demokracia përcaktohet si ide *kolektiviste*, meqë i bie të vendosim gjithçka së bashku dhe t’ju bindemi më pas atyre vendimeve. Kjo do të thotë se në demokraci gjithçka është çështje publike. Nuk ka *limite thelbësore ndaj këtij kolektivizmi*. Nëse maxhoranca (ose më mirë, qeveria) do, ne të gjithë duhet të veshim një parzmore kur ecim në rrugë, sepse kjo është më e sigurt. Ose të vishemi si klounë sepse do i bëjmë njerëzit për të qeshur. Asnjë liri individuale nuk është e shenjtë. Kjo i lë shteg ndërhyrjes në rritje të qeverisë – kjo aktualisht ndodh në shoqëritë demokratike.

E vërtetë se drejtimet politike mund të lëkunden nga më shumë në më pak rregulla, por në një këndvështrim të gjatë, demokracitë perëndimore për ditë e më tepër kanë shtim të ndërhyrjeve nga ana e shtetit, të varësisë më të madhe dhe shpenzimeve publike më të larta.

Kjo gjë nuk qe kaq e dukshme në periudhën e Luftës së Ftohtë, kur demokracitë perëndimore u krahasuan me shtete totalitare si Bashkimi Sovjetik dhe Kina e Mao Ce Dunit, që i bënë ato të duken relativisht më të lirë. Në atë kohë qe më pak e dukshme fakti se edhe ne vetë po bëheshim më kolektivistë. Që në vitet 1990-të, pas rënies së sistemit komunist, u bë e qartë se edhe shtetet tona me mirëqenie po ecnin në të njëjtin drejtim. Tashmë ne jemi tejkalar nga ekonomi të reja në lulëzim që ofrojnë më tepër liri, taksa më të ulëta dhe më pak rregulla se sa sistemet tona.

Natyrisht, shumë politikanë demokratikë reklamojnë tregun e lirë, por veprimet e tyre tregojnë të kundërtën. Merrni për shembull Partinë republikane, e cila shpesh konsiderohet si parti e sipërmarrjes së lirë. Ata kanë përqafuar në mënyrë virtuale gjithë politikat ndërhyrëse të avancuara nga rivalët e tyre të majtë – shtetin e mirëqenies, taksat e larta, shpenzimet e larta qeveritare, strehimin publik, ligjet e punës, pagën minimale, ndërhyrjet e huaja – madje kanë shtuar edhe ca nga ana e tyre, si: subvencionet për bankat dhe bizneset e mëdha, ligje kudër krimeve pa viktimë që janë përdorimi i drogës dhe prostitucioni. Pavarësisht ndonjë ndryshimi të ndonjë ligji me raste, fuqia e shtetit

është rritur. Kështu për shembull, nën drejtimin e republikanit Ronald Regan, shpenzimet e shtetit u rritën në vend që të uleshin. Pasardhësi i tij Xhorxh W. Bush i çoi këto shpenzime në qiell. Kjo tregon se demokracia nuk është neutrale, por çon drejt rritjes së kolektivizmit dhe të pushtetit qeveritar, pavarësisht se kush është në pushtet aktualisht.

TABELË - Shpenzimet qeveritare, përqindja e GDP-së

Ky trend i përgjithshëm reflektohet në rritjen e qëndrueshme të shpenzimeve publike. Në fillim të shekullit të njëzetë, shpenzimet publike si përqindje e prodhimit kombëtar bruto ishte rreth 10% në shumë demokraci perëndimore. Tani është rreth 50 %. Pra, gjashtë muaj në vit njerëzit kthehen në skllëvër dhe punojnë vetëm për shtetin.

Në periudha me pak demokratike barra e taksave që më e ulët se sot. Për disa shekuj Anglia kishte një sistem në të cilin mbreti kishte të drejtë të shpenzonte para, por jo të ngrinte taksat dhe Parlamenti kishte të drejtë të taksonte, por jo të shpenzonte para. Si pasojë, taksat kombëtare ishin relativisht më të ulëta. Në shekullin e njëzet, kur Britania u bë më demokratike, taksat filluan të ngriheshin vazhdimisht.

Revolucioni amerikan filloi si revoltë kundër taksave nga kolonialistët amerikanë kundër atdheut të tyre, Britanisë së Madhe. Themeluesit e Shteteve të Bashkuara e pëlqenin demokracinë, siç pëlqenin edhe taksat e larta, pra aspak. Fjala “demokraci” nuk shihet askund në Deklaratën e Pavarësisë apo në Kushtetutë.

Në shekullin e nëntëmbëdhjetë barra e taksave në ShBA ishte e vogël, përveç kohës së luftës. Taksa mbi të ardhurat nuk ekzistonte, madje që e ndaluar me Kushtetutë. Por, ndërkohë që ShBA-të u transformuan nga një shtet federal i decentralizuar në një demokraci kombëtare parlamentare, pushteti i qeverisë u rrit vazhdimisht. Kështu, për shembull, në vitin 1913 u fut taksa mbi të ardhurat dhe u krijua Sistemi i Rezervës Federale.

Një tjetër shembull mund të jepet me Kodin e Rregullores Federale (CFR), e cila liston të gjitha ligjet e aprovuara nga qeveria federale. Në vitin 1925 ekzistonte një libër i vetëm. Në vitin 2010 ishin gjithsej dyqind volume, ku vetëm indeksi zë rreth shtatëqind faqe. Ai përmban rregulla për gjithçka që ekziston në dritën e diellit, deri tek se si duhet prerë qepa nëpër restorante. Vetëm gjatë presidencës së George W. Bush, u shtuan çdo vit rreth 1000 faqe në rregulloren federale, raporton *The Economist*. Sipas së njëjtës reviste, nga viti 2001 deri në 2010 kodi taksor amerikan u rrit nga 1.4 milion fjalë në 3.8 milion fjalë. Shumë projektligje të propozuar në Kongres janë kaq të fryrë sa asnjë nuk e merr mundimin t'i lexojë para se të votohen. Pra ardhja e demokracisë ka çuar në shtim të madh të ndërhyrjes qeveritare në ShBA, ndonëse njerëzit shpesh pretendojnë se Amerika është vendi i “lirë”.

TABELË - Zgjerimi i Kodit të Taksave

Në demokracitë e tjera perëndimore ka ndodhur një zhvillim i ngjashëm. Për shembull, në Holandë, nga i cili vend janë edhe autorët e këtij libri, barra totale e taksave ishte 14% e prodhimit kombëtar bruto. Tani është 55%, sipas një studimi të Byrosë gjermane të Planifikimit Qendror. Sipas një tjetër studimi, shpenzimet qeveritare si përqindje të të ardhurave kombëtare ishin 10% nga 52% që qenë në 2002.

Në Holandë, numri i ligjeve dhe rregullave është shtuar vazhdimisht. Numri i ligjeve mbi librat u rrit me 72% në vitet 1980-2004, sipas një studimi të Qendrës Shkencore të Kërkimeve dhe Dokumentacionit në Departamentin holandez të Drejtësisë. Në vitin 2004 Holanda kishte në total 12,000 ligje dhe rregullore mbi librat, që përmbanin mbi 140,000 nene.

Problemi me tërë këto ligje është se ato tentojnë të detyrojnë njëri-tjetrin. Me fjalë të tjera, njëri ligj çon tek tjetri. Për shembull, nëse keni një sistem të sigurimit shëndetësor të imponuar nga shteti, qeveria nxitet të përpiqet të detyrojë njerëzit që të adoptojnë (supozohet) mënyrë jetese të shëndetshme. Thuhet se “ne” të gjithë paguajmë për kostot e larta mjekësore të njerëzve që nuk jetojnë shëndetshëm. Kjo është e vërtetë, por vetëm sepse qeveria e ka filluar me ngritjen e një sistemi kolektiv. Ky lloj fashizmi shëndetësor është tipik për vendet demokratike dhe pranohet në mënyrë rutinë nga shumica. E quajnë krejt normale që qeveritare dekreton të mos hanë ushqime me yndyrë apo me sheqer, të mos pinë duhan, e të venë kokore apo rripa sigurimi, e kështu me radhë. Këto të gjitha janë shkelje të drejtëpërdrejta të lirive individuale natyrisht.

Ndonjëri mund të thotë se gjatë dekadave të fundit liria ka avancuar në një numër sektorësh. Në shumë vende perëndimore, kompani televizive private (komerciale) kanë thyer monopolin e stacioneve transmetuese kombëtare, orët e mbajtjes hapur të dyqaneve janë shtuar, tregu i Telekomit është liberalizuar dhe në shumë vende rekrutimi është hequr. Megjithatë, shumë nga këto arritje është dashur të rrëmbeheshin nga duart e politikanëve demokratë. Në shumë raste, këto ndryshime nuk mund të ndaloheshin nga politikanët, sepse qenë rezultat i zhvillimeve teknologjike (siç qenë në media apo Telekom) ose i konkurrencës me vendet e tjera (si në rastin e linjave ajrore). Këto zhvillime mund të krahasohen me rënien e komunizmit në ish Bashkimin Sovjetik, që nuk ndodhi sepse njerëzit në pushtet donin ta linin pushtetin, por sepse nuk patën zgjidhje tjetër – sepse vetë sistemi që thyer e nuk mund të ndreqej. Në të njëjtën formë, edhe politikanët tanë herë pas here duhet të lëshojnë një çikë pe.

Por këta politikanë zakonisht e rikuperojnë humbjen shumë shpejt. Liria në internet, për shembull, ndikohet mjaft nga ndërhyrjet qeveritare. Liria e fjalës është reduktuar nga ligjet anti-diskriminuese. Prona intelektuale, të drejtat (patenta dhe e drejta e autorit) përdoren për të sunduar mbi lirinë e prodhuesve dhe konsumatorëve. Liberalizimi i tregjeve zakonisht shoqërohet me vendosjen e burokracive të reja që synojnë të rregullojnë tregjet e rinj. Këto agjenci burokratike pastaj tentojnë të zgjerohen dhe prezantojnë më tepër rregulla. Në Holandë, sektorë të tillë si energjia dhe Telekomu u liberalizuan vërtetë, por në të njëjtën kohë u krijuan agjenci të reja rregullatore, gjashtë prej të cilave vetëm në dhjetë vitet e fundit.

Në ShBA, sipas studiuesve të Universitetit të Virxhinias, kostoja e rregulloreve federale u ngrit me 3% nga 2003 në 2008 në 1,75 trilion dollarë në vit, ose në 12% të GDP-së. Mbas 2008-ës, rregullore të reja u prezantuan në tregjet financiare, industrinë e naftës, atë ushqimore dhe në sektorë të tjerë të biznesit. Në Evropë bizneset dhe ekonomitë shtëpiake nuk kanë vetëm qeveritë e tyre për të përballuar, por edhe vuajnë nga rregullat shtesë të Bashkimit Evropian në Bruksel. Ndërkohë që në voton 1990, Brukseli përmendej për liberalizimin, trendi sot të shpie në të kundërtën: përherë e më tepër drejt de-rregullimit.

Shkurtimisht, në praktikë demokracia nuk është politikisht neutrale. Sistemi është kolektiv në natyrë dhe çon drejt ndërhyrjes së shtuar qeveritare, duke ngushtuar liritë

individuale. Kjo ndodh sepse njerëzit vazhdojnë të kërkojnë nga qeveria dhe duan që të tjerët t'i paguajnë kostot.

Aktualisht, në esencë demokracia është ideologji totalitare, jo aq ekstreme sa nazizmi, fashizmi apo komunizmi. Në parim, liria është e shenjtë në demokraci, por çdo aspekt i jetës individuale i nënshtrohet kontrollit nga qeveria. Në fund të ditës, minoriteti është nën mëshirën e maxhorancës. Edhe nëse demokracia ka një kushtetutë që kufizon pushtetin e qeverisë, kjo kushtetutë aktualisht ndryshohet nga maxhoranca. E vetmja e drejtë parësore që keni në demokraci është e drejta e votës për një parti politike. Me këtë ju ia dorëzoni pavarësinë dhe lirinë tuaj vullnetit të maxhorancës.

Liria e vërtetë është e drejta për të zgjedhur e jo për të marrë pjesë në sistem e më pas për të paguar për të. Si konsumatorë, ju nuk jeni të lirë nëse iu detyrojnë të zgjidhni midis stacioneve të ndryshme televizive, pavarësisht se sa rrjete ju mund të preferoni. Ju jeni të lirë nëse mund gjithashtu të vendosni të mos blini një aparat televizori. Në demokraci, ju duhet të blini atë çfarë ka zgjedhur maxhoranca, ju pëlqen apo jo.

MITI 5 - DEMOKRACIA ÇON NË PROSPERITET

Shumë vende demokratike janë të pasura, ndaj njerëzit mendojnë se demokracia është e nevojshme për të arritur prosperitet. Por në fakt, vërtetohet e kundërta. Demokracia nuk të çon në prosperitet, por e shkatërron atë.

E vërtetë është që shumë vende perëndimore janë të begatë. Diku tjetër në botë kjo gjë nuk shihet. Kështu, Singapori, Hong Kongu dhe një numër i vendeve të Gjirit nuk janë demokratike, ndonëse të pasura. Shumë vende të Afrikës dhe Amerikës Latine janë demokratike, por jo të pasura, përveç një elite të vogël. Vendet perëndimore janë të zhvilluara për shkak dhe pavarësisht nga demokracia. Zhvillimi bëhet në sajë të traditës së lirisë që i karakterizon këto vende, si rezultat i së cilës shteti nuk është ende në kontroll të plotë të ekonomive të tyre. Por kjo traditë po dobësohet në vazhdimësi. Sektori privat është duke u pakësuar, një proces që kërcënon të shkatërrojë pasuritë e ndërtuara prej shekujsh.

Prosperiteti krijohet kudo ku mbrohen siç duhet të drejtat e individëve. Për ta thënë më ndryshe, pasuria krijohet aty ku njerëzit janë të aftë të vjelin frytet e punës së tyre. Në këtë situatë, njerëzit motivohen për të punuar më shumë, ndërmarrin rreziqe dhe i përdorin burimet e disponueshme më me efikasitet.

Nga ana tjetër, nëse njerëzit detyrohen t'ja japin frytet e punës së tyre shtetit – si në rastin e demokracisë – ata janë më pak të motivuar të bëjnë më të mirën. Për më tepër, shteti do i përdorë pashmangshmërisht këto burime në mënyrë jo efektive. Sepse drejtuesve (demokratikë) nuk ju është dashur të punojnë për të arritur burimet – dhe kanë objektiva krejt të kundërta me njerëzit që i krijojnë ato.

Si funksionon kjo gjë në demokraci? Mund ta krahasoni me një grup prej dhjetë vetë që po hanë darkë në një restorant dhe vendosin ta ndajnë llogarinë në mënyrë të barabartë. Meqë 90% e llogarisë do paguhet nga të tjerët, secili prej tyre motivohet të porosisë gjëra të shtrenjta për të ngrënë, gjë që s'do e bënin nëse do hanin vetëm e do paguanin vetë për gjithçka. Pra, fatura totale është tepër e shtrenjtë për tu paguar, nëse secili nuk merr përsipër pjesën e vet.

Në shkencën ekonomike, ky fenomen njihet si “Tragjedia e *Commons*”. *Commons* do të thotë një copë tokë që zotërohet kolektivisht e që përdoret nga fermerë të ndryshëm. Fermerët që e ndajnë këtë tokë kanë një nxitje të natyrshme për t’i lejuar bagëtisë e tyre të kullojnë sa të munden (në kurriz të të tjerëve), dhe nuk kanë asnjë stimul për t’i tërhequr në kohë bagëtisë nga kullota (sepse përndryshe do përfitonin bagëtisë e fermerëve të tjerë). Pra, meqë lëndina është pronë e të gjithëve por edhe e askujt, rezultati është shfrytëzimi në maksimum i saj.

Demokracia funksionon në të njëjtën mënyrë. Shtetasit inkurajohen të përfitojnë avantazhe në kurriz të të tjerëve – ose të kalojnë barrën e tyre tek të tjerët. Njerëzit votojnë për partitë politike që i lejojnë të tjerët të paguajnë për dëshirat e tyre personale (edukim falas, përfitime të larta mirëqenieje, subvencione për kujdesin ndaj fëmijëve, e kështu me radhë). Në shembullin e mësipërm të darkës, gjërat nuk dalin shumë jashtë kontrollit, sepse në një grup të vogël njerëzit i përmbahen kontrollit social, por kjo gjë nuk funksionon në demokraci me miliona votues.

Politikanët zgjidhen për të manipuluar këtë sistem. Ata menaxhojnë të mirat “publike”. Nuk i kanë ato pronë të tyre, kështu që nuk tregohen ekonomiqarë me to. Përkundrazi, nxiten të shpenzojnë sa më tepër që të munden, që të fitojnë besim dhe t’ja lënë faturën e shpenzimeve pasardhësve. Mbi të gjitha, ata duhet të kënaqin votuesit e tyre, kjo është më e rëndësishme se interesat afatgjatë të vendit. Rezultati është jo efikas dhe i shpërdoruar.

Jo vetëm që janë të destinuar të shpërdorojnë, por edhe të marrin sa më tepër për vete, sepse kur të largohen nga pushteti s’do e kenë më këtë mundësi.

Ky sistem është shkatërrues për ekonominë. Njerëzit duhet të ndërjegjësohen plotësisht për këtë fakt. Faturat shtetërore janë ende për tu paguar nga të gjithë.

Borxhi i madh qeveritar është rezultat i deficitit të madh, nga i cili jo aksidentalisht vuajnë të gjitha vendet demokratike. Në ShBA borxhi kombëtar ka arritur në mbi 14,000 miliard dollarë, rreth 50,000 dollarë për frymë. Në shumicën e vendeve evropiane situata është e njëjtë. Borxhi kombëtar holandez u rrit në 380 miliard euro në fund të vitit 2010 ose gati 25,000 euro për frymë. Këto borxhe do të paguhen një ditë prej taksa paguesve. Në Holandë interesi i borxhit shtetëror arriti në 22 miliard euro në vitin 2009, më tepër seç ishte shpenzuar për mbrojtjen apo infrastrukturën. Kjo gjë tregon një shpërdorim të qartë të parave.

Politikanët tanë jo vetëm që mbledhin taksa që i shpërdorojnë në mënyrë të vazhdueshme, por gjithashtu kontrollojnë sistemin tonë financiar – paratë tona. Njëpërmjet bankave qendrore si Federal Reserve apo European Central Bank, qeveritë tona demokratike përcaktojnë se çfarë përbën para (tender i ligjshëm), sa para krijohen dhe hyjnë në ekonomi dhe sa janë normat e interesit. Në të njëjtën kohë, ata kanë vështirësuar lidhjen që ekzistonte më parë midis parasë letër dhe vlerës së nënkuptuar, si për shembull ari. *I gjithë sistemi ynë financiar – përfshirë edhe kursimet dhe fondet e pensioneve, gjithë paratë që ne mendojmë se zotërojmë – bazohet mbi para letër të dekretuar dhe emetuar nga shteti.*

Avantazhi i qeverisë ndaj këtij sistemi është i dukshëm. Ata kanë “rubinetin e parave”, që mund ta hapin sa herë të duan. Asnjë monark absolut në të shkuarën nuk e ka bërë kaq lirshëm këtë gjë. Udhëheqësit demokratikë mund ta “fryjnë” ekonominë (dhe të mbushin xhepat e tyre), nëse duan të rrisin popullaritetin. E bëjnë këtë gjë njëpërmjet Bankës Qendrore, e cila nga ana e saj përdor bankat private për të kryer procesin e nxjerrjes së

parave. Sistemi është projektuar në mënyrë të tillë që bankave private t'ju jepet leje e veçantë për të dhënë hua të herëpashershme nga paratë e depozituara prej klientëve. Pra, përmes hileve të tilla, në ekonomi injektohen më tepër para letër apo në mënyrë elektronike.

Kjo gjë ka pasoja negative të shumta. Vlera e parasë bie. Ky proces ka një shekull që vazhdon. Dollari ka humbur rreth 95% të vlerës së tij që kur u krijua sistemi i rezervës Federale në 1913. Prandaj ne si shtetas vëmë re përherë e më shumë shtrenjtim të shërbimeve. Në një treg vërtetë të lirë çmimet kanë tendencë të bien në mënyrë të vazhdueshme, si rezultat i përmirësimeve dhe konkurrencës mes produkteve. Por në sistemet tona të manipuluar nga qeveritë, në të cilat oferta për para rritet gjatë gjithë kohës, po ashtu rriten edhe çmimet. Disa njerëz përfitojnë nga kjo gjë (për shembull, ata që kanë borxhe të mëdha, si vetë qeveria), por të tjerët përkeqësohen, si për shembull kush jeton me pensione fikse apo kursime.

Pasoja e dytë është se me paratë e reja që futen në ekonomi, bumet artificiale ushqejnë njëri tjetrin. Kështu shohim bum në shitblerje pasurish të patundshme, mallrash apo bursash. Por të gjitha këto mrekulli janë një vrimë në ujë, tullumbace që do pëlcastin një ditë. Ato ndodhin vetëm se tregu u mbush me kredi të lehta dhe se të gjithë lojtarët u mbuluan nga borxhet. Kjo festë nuk vazhdon dot gjatë. Kur bëhet e qartë s'borxhet s'paguhen dot, tullumbacja plas dhe fillon recesioni.

Autoritetet përgjithësisht i përgjigjen recesionit duke krijuar më tepër para artificiale e duke i futur ato në ekonomi në sasi më të madhe (e sigurisht duke fajësuar tregun e lirë dhe spekulatorët për krizën). E bëjnë këtë sepse kjo është çfarë presin votuesit prej tyre. Votuesit duan që festa të vazhdojë sa më gjatë – dhe politikanët zakonisht i plotësojnë dëshirat e tyre ngaqë duan të rizgjidhen.

Shkrimtari dhe politikan i amerikan Benjamin Franklin e ka vërejtur këtë problem që gjatë shekullit të tetëmbëdhjetë. “Kur njerëzit shohin se mund të votojnë para, do të paralajmërojnë fundin e republikës” – shkroi ai.

Në kohën tonë kemi arritur në atë pikë që s'mund të krijojmë më tullumbace të reja. Autoritetet nuk dinë ç'të bëjmë më. Nëse vazhdojnë të krijojnë para, rrezikojnë mbi inflacion, si në 1920 në Gjermani ose kohët e fundit në Zimbabve. Në të njëjtën kohë, ata nuk guxojnë të ndalojnë fryrjen e ekonomisë, sepse kjo do e çonte atë në recesion dhe votuesit nuk do e pëlqenin këtë. Me një fjalë, sistemi duket i ngecur në vend. Qeveritë nuk mund ta mbështesin më gjatë iluzionin që krijuan, por as mund ta braktisin atë.

Pra, ne e kuptojmë se demokracia nuk të çon në prosperitet, por në inflacion e recesion të vazhdueshëm, me gjithë pasiguritë dhe jo stabilitetin që krijon. Cila është alternativa? Zgjidhja për shpenzimet qeveritare pa fre është të kthejmë respektin për pronën private. nëse fermerët do kenë tokën e tyre, do sigurohen që të mos e shpërdorojnë atë. nëse shtetasit vjelin frytet e punës së tyre, do sigurohen që të mos shpërdorojnë burimet e kësaj pune.

Kjo gjithashtu do të thotë që sistemi financiar duhet të mos lihet më në duar të politikanëve. Sistemi monetar, si çdo aktivitet ekonomik, duhet të bëhet pjesë e tregut të lirë përsëri. Secili duhet të ketë mundësi të nxjerrë paranë e ti ose të pranojë formën që dëshiron. Mekanizmat e tregut të lirë do sigurojnë që të mos krijohen tullumbace artificiale – të paktën jo në madhësinë që kemi përjetuar gjatë manipulimeve qeveritare në sistemin tonë financiar.

Për shumë njerëz një sistem monetar i tregut të lirë mund të duket i frikshëm, por historikisht ka qenë rregull dhe jo përjashtim. Mund të na ndihmojë që të arrijmë prosperitet – pasurinë fantastike që gëzojmë aktualisht – që në fund konsiston në atë që ne së bashku si shtetas produktivë prodhojmë dhe kemi prodhuar në formën e të mirave apo shërbimeve reale. As më shumë, as më pak. Të gjitha rrengjet dhe mirazhet e qeverive tona demokratike të lidhura me paranë nuk e ndryshojnë këtë fakt.

MITI 6 - DEMOKRACIA ËSHTË E NEVOJSHME PËR TË SIGURUAR NJË NDARJE TË DREJTË TË PASURISË DHE PËR TË NDIHMUAR TË VARFRIT.

A nuk është e nevojshme demokracia për të siguruar një ndarje të drejtë të pasurisë? Politikanët flasin shpesh për solidaritet dhe ndarje të drejtë, natyrisht, por sa të drejta janë skemat e tyre? Për ta filluar, përpara se të ndahet, pasuria duhet krijuar. Subvencionet dhe shërbimet qeveritare nuk janë falas, ndonëse shumë njerëz mendojnë të kundërtën. Gati gjysma e asaj që fitohet nga prodhuesit, merret nga qeveria dhe pastaj rishpërndahet.

Le të supozojmë se shteti duhet ta rishpërndajë pasurinë mes shtetasve të vet. Pyetja shtrohet – A të çon sistemi demokratik në një shpërndarje të drejtë? A shkon vërtetë paraja tek ata njerëz që kanë më tepër nevojë? Sikur të ishte e vërtetë! Shumica e grandeve dhe subvencioneve shkojnë për grupe të caktuara interesi. Për të dhënë një shembull, 2/5-at e buxhetit të BE-së harxhohen për subvencione fermerësh.

Grupe lobiste luftojnë pafundësisht për grande, privilegje dhe vende pune. Secili do të grabisë sa më tepër nga fondet publike. Në këtë sistem, parazitizmi, favoritizmi dhe varësia inkurajohen, ndërsa përgjegjësia individuale dhe vetë-mbështetja dekurajohen. Të përmendim disa grupe të veçanta interesi, të cilët përfitojnë nga këto marrëveshje, megjithëse nuk janë të varfër apo të pa avantazhuar: agjenci reklamash zhvillimi, banka, korporata të mëdha, fermerë, stacione televizivë publikë, organizata mjedisi, institucione kulturore. Ata arrijnë të marrin miliona para nëpërmjet grandeve dhe subvencioneve sepse kanë akses direkt ndaj pushtetit. Përfituesi më i madh neto janë natyrisht punonjësit civilë që drejtojnë sistemin. Ata sigurohen të jenë të pazëvendësueshëm dhe e shpërblejnë veten me rroga.

Grupet e veçanta të interesit jo vetëm që përfitojnë nga qeveria, por dinë gjithashtu se si të influencojnë legjislacionin për të përfitur në kurriz të pjesës tjetër të shoqërisë. ka shembuj të panumërt për këtë. Mendoni pak kufizimet në import dhe kuotat që i japin përfitime sektorit bujqësor, por nga ana tjetër rrisin çmimet e ushqimeve. Apo sindikatat që, së bashku me politikanët, mbajnë rrogat minimale të larta, duke kufizuar kështu konkurrencën në tregun e punës. Kjo shkon në kurriz të atij që ka më pak arsim, i cili nuk mund të gjejë punë sepse kjo gjë ju kushton shumë kompanive që mund ta punësojnë.

Një shembull tjetër janë ligjet licencuese, një mënyrë e zgjuar për të mbyllur konkurrencën e pa mirëpritur. Farmacistët i përdorin ligjet e licencimit për të bllokuar konkurrencën nga farmacitë apo furnizuesit në internet. Profesionit mjekësor bllokun konkurrencën nga siguresit e “pa licencuar” të kujdesit shëndetësor. Një shembull që lidhet me këtë është sistemi i patentave dhe të drejtës së autorit të dhëna nga qeveria, të

cilat kompanitë ekzistuese, për shembull në industrinë farmaceutike dhe atë argëtuese, i mbajnë të ardhurit të fshehura.

A nuk mund të ngrihen votuesit në revoltë kundër grupeve lobiste të veçanta përfituese? Në teori kjo është e mundur. Por në praktikë ndodh rrallë, sepse përfitimet që gëzojnë këto grupe të veçanta interesi tejkalon së tepërmi koston ndaj anëtarëve individualë të publikut. Për shembull, nëse një kile sheqer bëhet tre qindarka më shtrenjtë për shkak të importit, kjo mund të jetë mjaft fitimprurëse për prodhuesit vendas të sheqerit (dhe për shtetin), por për individët konsumatorë nuk ja vlen të protestojnë. Pra grupet e interesit janë më të motivuar të marrin përfitime, ndërkohë që masa e gjerë e votuesve është shumë e zënë për të vrarë mendjen.

Shumë njerëz nuk janë aspak të ndërgjegjshëm për ekzistencën e këtyre marrëveshjeve të ëmbla. Megjithatë, të gjitha këto skema të marra së bashku rezultojnë në kosto të rëndësishme – e kështu në standarde më të ulëta jetese – për të gjithë ne që nuk kemi lobistë që punojnë për ta në Uashington apo në ndonjë kryeqytet tjetër. Politika demokratike në mënyrë të pashmangshme degjeneron në një makinë rishpërndarje me klubet më me influencë e më të mirë-organizuar, që përfitojnë në kurrizin tonë. Pa vend të thuash se sistemi funksionon në të dyja drejtimet, në kuptimin që grupet lobiste i kthejnë favorët që marrin duke sponsorizuar fushatat politike.

Në Holandë, e cila mund të konsiderohet si vendi tipik demokratik evropian me mirëqenie, Byroja e Planifikimit Social dhe Kulturor (një agjenci qeveritare), botoi një raport në vitin 2011 ku nxirrej përfundimi se grupet me të ardhura mesatare përfitojnë më pak nga qeveria se sa grupet me të ardhura të ulëta apo të larta. Në fakt, studiuesit gjetën se përfitimet më të mëdha merreshin nga grupet me të ardhura të larta. Studimi i përmbahej vetëm vitit 2007, por s'ka arsye pse të mos supozojmë se ende jemi në të njëjtën situatë. Ky grup ende përfiton më tepër nga subvencionet qeveritare për arsimin e lartë, kujdesin për fëmijët dhe artet.

Shumë njerëz kanë frikë se, nëse edukimi, kujdesi shëndetësor, transporti publik, strehimi e kështu me radhë, i lihen “forcave të tregut të lirë”, të varfrit nuk do mund t'i përballojnë këto shërbime. Por tregjet e lira aktualisht bëjnë një punë të mirë për t'ju siguruar të varfërve. Ato sigurojnë produkte të cilësisë së lartë me çmime të ulëta, me mundësi të shumta zgjedhjeje. Përmes inovacionit dhe konkurrencës, tregu i lirë ka krijuar mundësinë për grupet me të ardhura të pakta. siç janë ato të punëtorëve të krahut apo studentëve, të gëzojnë të mira si makina, kompjuterë, celularë dhe udhëtime me avion, të cilat dikur i përballonin vetëm të pasurit. Nëse kujdesi për të moshuarit organizohet si supermarketet, për shembull, pa ndërhyrjen e shtetit, a nuk do shihnim rezultate të ngjashme? Në këtë mënyrë, të moshuarit dhe të afërmit e tyre do vendosnin në lidhje me shërbimet që ju nevojiteshin dhe çmimin që do paguanin. Do kishin më tepër kontroll mbi kujdesin që marrin dhe mbi pagesën për të.

A nuk do vuante cilësia, nëse shteti nuk do ndërhynte më në shkolla, spitale apo në kujdesin shëndetësor? Ndodh krejt e kundërta. Si do të që cilësia e dyqaneve ushqimore nëse ato organizoheshin njësoj si shkollat publike? Nuk mund të presësh që një grusht “specialistësh” nga Uashington DC të menaxhojnë me efektivitet sektorë të mëdhenj dhe kompleksë, siç janë edukimi dhe kujdesi shëndetësor. Me reformat e tyre pa fund, komitetet, komisionet, letrat e bardha, direktivat, udhëzuesit dhe shkurtimet, ata nuk prodhojnë asgjë, përveç se më tepër burokraci.

Ekspertët e vërtetë janë nëpër shkolla dhe spitale. Ata dinë më tepër rreth fushave të tyre të ekspertizës dhe janë më në gjendje të organizojnë me efikasitet institucionet e tyre. Nëse nuk e bëjnë siç duhet këtë gjë, atëherë nuk do mbijetojnë dot në tregun e lirë. Për këtë arsye, cilësia e edukimit dhe e kujdesit shëndetësor pa ndërhyrjen e qeverisë do të përmirësohej në vend që të përkeqësohej. Burokracia, listat e pritjes dhe klasat e stërmbushura me nxënës do të zhdukeshin. Ashtu siç ka shumë pak supermarkete të ndotur, që tregtojnë ushqim të keq, ose okulistë me lista pritjesh për pacientët në më tepër se një vit. Në tregun e lirë, këta nuk do mund të mbijetonin.

Sigurisht, ka gjithmonë disa njerëz që nuk janë në gjendje të ndihmojnë veten. Këtyre u nevojitet ndihmë. Por nuk është e nevojshme të krijohet makina e rishpërndarjes në masë e sistemit tonë demokratik për t'i ndihmuar ata. Kjo mund të kryhet nëpërmjet institucioneve private apo të bamirësisë – apo nga kushdo tjetër që do të japë ndihmë. Supozimi se na duhet demokracia për të ndihmuar të varfrit dhe të pa avantazhuarit është një flluskë sapuni në interes të atyre që përfitojnë nga makina e rishpërndarjes.

MITI 7 - DEMOKRACIA ËSHTË E NEVOJSHME PËR TË JETUAR SË BASHKU NË HARMONI

Njerëzit shpesh mendojnë se konfliktet mund të shmangen, nëse vendimet merren demokratikisht. Mendohet se , nëse secili ndjek prirjet e tij, atëherë nuk mund të jetohej në paqe.

Kjo mund të jetë e vërtetë kur një grup njerëzish duhet të vendosë nëse të shkojë në kinema apo në plazh. Në fakt, ka shumë çështje për të cilat s'mund të vendoset demokratikisht. Kjo sepse në demokraci të gjitha llojet e çështjeve personale dhe sociale kthehen në probleme të përbashkëta. Duke i detyruar njerëzit t'ju binden vendimeve demokratike, i çon ata në marrëdhënie aspak harmonike.

Për shembull, është vendosur demokratikisht se çfarë të mësojnë fëmijët në shkollë, se sa para të shpenzohen për kujdesin ndaj të moshuarve, sa ndihmë t'ju jepen vendeve të botës së tretë, nëse duhet ndaluar pirja e duhanit nëpër lokale, cilat stacione televizive të subvencionohen, cilat trajtime mjekësore mbulohen nga shteti, sa të larta duhet të jenë qiratë, nëse grave u lejohet të vënë shami në kokë, cilat droga janë të ligjshme, e kështu me radhë. Të gjitha këto vendime krijojnë tensione dhe konflikte. Këto konflikte mund të shmangen lehtësisht, nëse njerëzit bëjnë zgjedhjet e tyre dhe marrin përgjegjësi për pasojat.

Supozojmë se vendosëm demokratikisht se sa bukë dhe çfarë lloj buke të prodhohet përditë. Kjo do të çonte në lotime pa fund, takime e protesta. Përkrahësit e bukës së bardhë do i konsideronin ata të bukës së zezë si armiq politikë. Nëse përkrahësit e bukës së zezë do merrnin shumicën e subvencioneve, i bie që buka e bardhë një ditë të ndalohej. Por mund të ndodhte dhe e kundërta.

Demokracia është si një autobus i mbushur plot me njerëz, të cilët duhet të vendosin se ku të shkojë shoferi. Progresistët votojnë për San Franciskon, konservatorët preferojnë Dallas-in, libertarianët duan të shkojnë në Las Vegas, të gjelbërit në Woodstock dhe pjesa që mbetet në njëmijë drejtime të tjera. Më në fund autobusi mbërrin në një vend ku askush nuk do të jetë. Edhe nëse vetë shoferi nuk ka interes dhe dëgjon me vëmendje se

çfarë i kërkojnë pasagjerët, ai asnjëherë nuk do mund t'jua plotësojë dëshirat. Ka vetëm një autobus, ndërkohë që ka aq shumë dëshira sa edhe pasagjerë.

Kjo është arsyeja pse të sapo ardhurit në pushtet, që në fillim konsiderohen si shpëtimtarë, në fund përfundojnë gjithmonë zhgënjyes. Asnjë politikanë nuk arrin dot të pamundurën. “Po ne mundemi” përfundon gjithmonë në “Jo nuk mundemi”. As edhe personi më i mençur i botës nuk arrin dot të plotësojë dëshirat e kundërta.

Nuk është koincidence që diskutimet mes njerëzve janë shpesh kaq emocionale. Në fakt, ata preferojnë të mos flasin rreth politikës kur takohen. Kjo sepse kanë ide të ndryshme se si duhet të jetohet, ndërkohë që në demokraci këto pikëpamje duhet të pajtohen.

Zgjidhja ndaj problemit të autobusit është e thjeshtë. T'i lemë njerëzit të vendosin vetë se ku duan të shkojnë dhe me kë, se si duan të jetojnë; le t'i zgjidhin vetë problemet e tyre, të formojnë grupet e tyre; le të vendosin vetë se çfarë të bëjnë me trupin, mendjen dhe paratë e tyre. Në këtë mënyrë, shumë “probleme” politike do zhdukeshin si me magji.

Por në demokraci ndodh krejt e kundërta. Sistemi i inkurajon njerëzit t'i kthejnë preferencat e tyre personale në qëllime kolektive që duhet t'i ndjekë kushdo. Inkurajohen ata që duan të shkojnë në X vend, që t'i detyrojnë të tjerët të bëjnë si ata. Një pasojë fatale është që njerëzit shtyhen të formojnë grupime që të hyjnë në konflikte me të tjerët. Kjo sepse vetëm kur je pjesë e një grupi të madh (apo blloku votues) ka shanse që t'i ktheni idetë në të ligjshme. Kështu të vjetrit dalin kundër të rinjve, fermerët kundër qytetarëve, emigrantët kundër vendasve, Kristianët kundër Myslimanëve, besimtarët kundër ateistëve, punëdhënësit kundër punonjësve, e kështu me radhë. Sa më i madh dallimi midis njerëzve, aq më të ashpra bëhen marrëdhëniet mes tyre. Kur një grup e quan homoseksualitetin mëkat, ndërkohë që grupi tjetër i kthen ata në modele për shkollat dhe materialet edukative, atëherë ata do përplasen në mënyrë të pashmangshme.

TABELË - SKEMA E CIKLIT ZGJEDHOR

- *Ne duam edukim falas për fëmijët tanë dhe kërkojmë që të paguajë ai për këtë.*
- *Unë dua subvencione dhe nxitës korporate dhe kërkoj që të paguajë ajo për këtë.*
- *Unë dua të rris luftën kundër terrorizmit dhe kërkoj që të paguajnë ata për këtë.*
- *Unë dua receta falas dhe kërkoj që ai të paguajë për këtë.*

Pothuajse të gjithë e kuptojnë se liria e fesë e zhvilluar me shekuj qe një ide mjaft e arsyeshme për të shmangur konfliktet mes grupeve të besimit. Pra Katolikët nuk mund t'ju diktonin jetën e tyre Protestantëve, apo e kundërta. Pak njerëz sot duket se e kuptojnë që tensionet krijohen kur, përmes sistemit tonë demokratik, punonjësit ju diktojnë punëdhënësve se si të drejtojnë bizneset e tyre, të moshuarit bëjnë që të rinjtë të paguajnë për pensionet e tyre, bankat bëjnë që qytetarët të paguajnë për investimet e tyre të gabuara etj.

Shpërblehesh në rastet kur e paraqet grupin si të dobët, të diskriminuar apo pa të drejta. Kjo gjë të jep një argument ekstra për përfitime qeveritare, si dhe i jep qeverisë argument për të justifikuar ekzistencën e saj dhe për t'i dhënë përfitimet në emër të “drejtësisë sociale”.

Siç ka thënë edhe shkrimtari amerikan H.L.Mencken: “ Ato çfarë vlerësojnë njerëzit në këtë botë janë privilegjet, jo të drejtat”. Kjo zbatohet me shumë grupe të shoqërisë dhe është e dukshme në demokraci. Dikur gratë, njerëzit me ngjyrë apo homoseksualët

luftonin për liri dhe të drejta të barabarta; sot, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre modernë, ata kërkojnë privilegje si kuota, veprime afirmative dhe ligje anti-diskriminuese që kufizojnë fjalën e lirë. E quajnë këtë gjë të drejtë, por meqë këto të drejta zbatohen vetëm për grupe të caktuara, në fakt janë privilegje. të drejtat e vërteta, si e drejta e fjalës së lirë, zbatohet për këdo, ndërkohë që privilegjet vetëm për grupe të caktuara. Ato mbështeten mbi forcën sepse i detyrojnë të tjerët të paguajnë për ta.

Një taktikë tjetër e ndjekur për të përfituar favore nga sistemi demokratik është duke prezantuar kauzën si të nevojshme, për të shpëtuar shoqërinë nga shkatërrimi. Nëse nuk shpëtojmë klimën, apo euron, apo bankat, shoqëria shembet sepse përfshihet nga kaosi dhe miliona njerëz e vuajnë. H.L.Mencken vazhdon kështu: “Nevoja për të shpëtuar njerëzimin është përherë një front fals, është nevojë për të sunduar.” Vini re se në demokraci njerëzit nuk kanë pse t’i vendosin paratë aty ku është goja e tyre. Ata mund të mbrojnë emigrantët ilegalë nëse ndodh që jetojnë në një vend ku nuk shqetësohen prej tyre. Mund të votojnë për subvencione, orkestra apo muze, për të cilat ata vetë nuk do blinin bileta të shtrenjta, duke e ditur se kostoja e subvencioneve do mbahej prej të tjerëve.

Njerëz të tillë shpesh shfaqin shenjë superioriteti moral. “Ne nuk duam ta ekspozojmë artin në ekonominë e tregut” – pretendon propozuesi i subvencioneve të artit. Ajo që nënkupton në të vërtetë është se nuk e do këtë gjë dhe se mendon që pjesa tjetër e shoqërisë duhet të paguajë për këtë tuj.

Fjala “Ne” është fjala me të cilën abuzohet më tepër në demokraci. Propozuesit e një mase thonë gjithmonë “ne duam diçka”. “ne duhet të bëjmë diçka”, “neve na duhet diçka”, “ne kemi të drejta”. Sikur të ishin të gjithë dakord në mënyrë të natyrshme. Ajo çfarë duan të thonë është se ata e dëshirojnë diçka, por nuk duan të mbajnë përgjegjësi për të. Njerëzit do të thonë: “ne duam të ndihmojmë vendet e Botës së Tretë” ose “ne duhet të luftojmë në Afganistan”. Ata kurrë nuk thonë “ Unë do t’i ndihmoj vendet e Botës së Tretë. Kush bashkohet me mua?” apo “Unë do luftoj kundër Talebanëve”. Kështu demokracia ofron një mënyrë me leverdi për të hequr përgjegjësitë personale e për t’jua vënë ato të tjerëve. Duke thënë “ne” në vend të “unë”, 99.999% e barrës së një vendimi të marrë bie mbi të tjerët.

Partitë politike kujdesen për të. Ato hapur ose fshehurazi premtojnë se barra e synimeve të tyre do mbahet nga pjesa tjetër e njerëzve. Kështu, të majtët thonë: “Votoni për ne, do jua marrim paratë të pasurve dhe do t’jua japim”. Ndërsa të djathtët thonë: “Votoni për ne. Do financojmë luftën në Afganistan me paratë e atyre që janë kundër kësaj lufte”. Të gjithë ju thonë fermerëve: “ Votoni për ne. Do sigurojmë që subvencionet e fermave të paguhen nga jo fermerët.”

A është ky një sistem i vullnetit të mirë dhe solidaritetit, apo është një sistem parazit antisocial?

I ashtuquajturi solidaritet në demokraci bazohet përfundimisht mbi forcën. Solidariteti i detyruar është vërtetë kontradiktor. Që të jetë i vërtetë duhet të mbështetet mbi veprime vullnetare. Nuk mund të thuash se dikush që e grabisin në rrugë tregon solidaritet me hajdutin, pavarësisht se sa fisnike ishin motivet e hajdutit.

Fakti është se ata që e përdorin sistemin demokratik për të detyruar solidaritet, e bëjnë sepse nuk e paguajnë vetë këtë gjë. Ata kurrë nuk përkrahin faktin që rishpërndarja e pasurisë të kryhet në shkallë globale. Nëse kjo ndarje me njerëz më të pafat është e drejtë, pse të mos zgjerohen skemat e mirëqenies për gjithë botën? Pse të mos krijohet një

drejtësi sociale shkallë botërore? Duket se përkrahësit perëndimorë të rishpërndarjes me kuptojnë se rishpërndarja e pasurisë do ulë fitimet e tyre. Por sigurisht, nuk e kanë problem ta ndajnë “në mënyrë të drejtë” me njerëzit më të pasur.

Nëse do të japësh para, s’ke nevojë që të vendosësh shumica për këtë. Mjafton liria jote. Je i lirë të hapësh portofolin tënd e të japësh sa para të duash. Mund t’i dhurosh për bamirësi ose të bashkohesh me të tjerë që ndajnë idetë e tua e t’i dhurosh paratë në grup. Nuk ka justifikim të detyrosh pjesën tjetër të njerëzve që të bëjnë të njëjtën gjë.

MITI 8 - DEMOKRACIA ËSHTË E DOMOSDOSHME NË KOMUNITET

Në demokraci, çdo dallim në opinione të shpie në luftë për pushtet dhe fitime të një grupi në kurriz të një tjetri. Gjithsecili kërkon nga shteti dhe shteti detyron të tjerët t’i plotësojnë këto kërkesa. Nuk mund të ndodhë ndryshe, sepse shteti është thjesht një instrument pushteti që vepron me detyrim.

Rezultat i këtij sistemi është fakti që njerëzit llastohen, kërkojnë më tepër nga pushtetarët dhe ankohen nëse ata nuk jua plotësojnë. Në të njëjtën kohë, nuk kanë shanse përveçse të marrin pjesë në sistem. Nëse jo, do të rrëmbehet nga pjesa tjetër e popullsisë. Në këtë mënyrë, sistemi minon vetë mbështetjen e njerëzve – aftësinë e tyre për t’ja dalë mbanë. Në të njëjtën kohë, minohet edhe vullneti i njerëzve për të ndihmuar të tjerët, sepse ata vazhdimisht detyrohen ta bëjnë këtë gjë.

Mentaliteti i njerëzve është bërë tashmë kaq “i demokratizuar” sa që nuk e kuptojnë dot mësa antisociale janë veprimet dhe idetë e tyre. Sot, gjithkush që dëshiron të krijojë një klub sportiv, një ngjarje kulturore, një qendër për kujdesje ditore, një organizatë mjedisore etj., përpiqet në fillim të marrë një lloj subvencioni nga pushteti lokal apo qendror. E thënë ndryshe, duan që të tjerët të paguajnë për hobet e tyre. Kjo gjë s’është fare pa logjikë, sepse po se bëre ti, do e bëjë dikush tjetër e ti do paguash. Por sistemi ka pak të bëjë me idenë e komunitetit që e lidhin me demokracinë. Më tepër ka të bëjë me mbijetesën e më të përgatiturit në përpjekje për të zhvatur taksa.

Ludvig Erhart, ish-kancelari gjerman dhe arkitekti i mrekullisë ekonomike gjermane të pas-luftës, e përligj këtë problem të demokracisë. “Si mund të vazhdojmë të sigurojmë progres kur në vazhdimësi adoptojmë një mënyrë jetese ku askush nuk ka dëshirë të marrë përgjegjësi për veten dhe ku çdokush kërkon siguri në kolektivizëm? Nëse kjo mani vazhdon, shoqëria jonë do degjenerojë në një sistem social, në të cilin secili i ka futur duart në xhepin e tjetrit”.

Por ndonjëri mund të pyes, a nuk do e humbim sensin kombëtar të unitetit, nëse nuk do vendosnim më bashkërisht? Pa dyshim që është e vërtetë se një vend është komunitet, në një sens të caktuar. Nuk ka gjë të gabuar këtu. Madje mund të jetë gjë e mirë. Shumica e njerëzve nuk e pëlqejnë vetminë, kanë nevojë për shoqëri, madje u duhet njeri-tjetri edhe për arsye ekonomike.

Por pyetja ngrihet: A është demokracia e rëndësishme për këtë ndjenjë uniteti? E vështirë të thuash pse. Kur flitet për një komunitet, flitet për më shumë se një pushtet politik. Njerëzit ndajnë me njeri-tjetrin gjuhën, kulturën, historinë. çdo vend ka heronjtë e vet kombëtarë, njerëzit e famshëm dhe yjet e sportit, por gjithashtu letërsinë, vlerat kulturore,

etikën e punës dhe mënyrën e jetesës. Asnjëra nga këto nuk lidhet me sistemin demokratik, kanë ekzistuar përpara se demokracia të lindte dhe nuk ka arsye pse të mos vazhdojnë të ekzistojnë edhe pa demokracinë.

Në të njëjtën kohë, asnjë vend nuk ka një kulturë tërësore uniform. Brenda çdo vendi ka dallime të mëdha mes njerëzve, shumë fe dhe komunitete etnike me lidhje të forta. As kjo nuk është e gabuar. Brenda kuadrit të një shoqërie të lirë, të gjitha këto struktura dhe performanca sociale mund të bashkëjetojnë. Por duhet të kuptohet se ato janë vullnetare, nuk detyrohen nga shteti, sepse kulturat dhe komunitetet janë njësi organike. Nuk mund të mbahen me forcë qeveritare e pak kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Dallimi mes këtyre komuniteteve sociale dhe demokracisë është se një demokraci është një organizatë ku anëtarësimi është i detyruar. Një komunitet i vërtetë bazohet mbi pjesëmarrje vullnetare. Një komunitet i tillë mund të ketë rregulla “demokratikë”, natyrisht. Anëtarët e një klubi tenisi mund të votojnë për kryetarin e tyre, për kupton e anëtarësimin e kështu me radhë. Kjo nuk është e gabuar. Kemi të bëjmë me një shoqatë private dhe anëtarët janë të lirë të hyjnë ose jo në të. Nëse nuk ju pëlqen mënyra se si drejtohet klubi, mund të shkojnë në një klub tjetër ose të hapin vetë një të tillë. Natyra vullnetare e klubit siguron një drejtim të mirë. Nëse, për shembull, bordi do merrej me favoritizëm, shumë anëtarë do largoheshin. Por në sistemin tonë demokratik nuk e ke mundësinë për tu larguar dot. Demokracia është e detyrueshme.

Ndonjëherë njerëzit thonë “duaje ose braktise” kur flasin për vendin e tyre. Kjo nënkupton që vendi i përket shtetit, kolektivitetit dhe se çdo njeri që aksidentalisht ka lindur aty, është i përcaktuar të jetë subjekt i shtetit. Megjithëse njerëzve nuk ju është dhënë kurrë një zgjedhje.

Nëse dikush në Sicili zhvatet nga Mafia, asnjë nuk thotë “duaje ose largohu”. Nëse në një vend homoseksualët futen në burg, njerëzit nuk thonë “ata nuk ankohen dot, sepse po të mos ju pëlqenin rregullat, duhej të kishin emigruar”. Por Sicilia nuk zotërohet nga Mafia, po ashtu edhe ShBA-të (ose ndonjë shtet tjetër) nuk zotërohen nga shumica apo qeveria. Çdo person zotëron jetën e vet, gjë që s’ka të bëjë me çfarë dëshiron maxhoranca. Njerëzit kanë të drejtë të bëjnë atë që duan me jetën e tyre, për sa kohë që nuk dëmtojnë të tjerët me dhunë, mashtrim apo vjedhje. Kjo e drejtë është, në një shkallë të lartë, e mohuar në sistemet tona demokratike parlamentare.

MITI 9 - DEMOKRACI DO TË THOTË LIRI DHE TOLERANCË

Një nga mitet më jetëgjatë të demokracisë është barazia që i venë asaj me lirinë. Për shumë njerëz, demokracia dhe liria i përkasin njëra-tjetrës, njësoj si yjet dhe hëna. Por në fakt është krejt e kundërta. Në demokraci, gjithkush duhet t’i nënshtrohet vendimeve të qeverisë. Fakti që qeveria zgjidhet nga shumica nuk do të thotë gjë. Detyrimi është njësoj detyrim, edhe nëse ushtrohet nga maxhoranca, edhe nga një njeri i vetëm. Në demokracitë tona asnjë nuk mund t’i shmangë vendimet e qeverive. Nëse nuk bindesh, do gjobitesh dhe, nëse refuzon të paguash, do përfundosh në burg. Përpiqu për shembull të mos paguash një gjobë trafikut, apo ndonjë taksë. Në këtë kuptim, nuk ka ndonjë dallim të madh mes demokracisë dhe diktaturës. Për dikë si Aristoteli, i cili jetoi në kohën kur

demokracia nuk ishte sanksionuar ende, kjo gjë që e dukshme. Ai shkroi: “Demokracia e pakufizuar është si oligarkia, një tirani e përhapur mbi një numër të madh njerëzish”.

Liri do të thotë që nuk ke pse bën atë që bën shumica, që mund të vendosësh për veten. Siç e ka thënë edhe ekonomisti John T. Wenders, “Ka një dallim mes demokracisë dhe lirisë. Liria nuk mund të matet me mundësinë për të votuar, por mund të matet me qëllimin e arsyes se përse nuk votojmë”.

Ky qëllim është shumë i kufizuar në demokraci. Demokracitë tona nuk na kanë sjellë lirinë, por të kundërtën. Qeveria ka nxjerrë ligje pa fund që bëjnë të pamundura shumë marrëdhënie e ndërveprime sociale vullnetare. Qiramarrësit dhe qiradhënësit nuk janë të lirë t’i bëjnë kontratat si të duan; punëdhënësit dhe punëmarrësit nuk janë të lirë të bien dakord me pagën dhe me kushtet e punës që dëshirojnë; mjekët dhe pacientët nuk mund të vendosin vetë mbi trajtimin mjekësor; shkollat po ashtu nuk janë të lira të mësojnë çfarë mendojnë se duhet. Në shumë vende, partitë politike duhet t’i lejojnë gratë që të kandidojnë për poste. Kjo ka pak të bëjë me lirinë.

Ligjet që ndërhyjnë tek liria e njerëzve për të hyrë në marrëveshje vullnetare i japin përfitime grupeve të caktuar dhe lëndojnë të tjerët. Përfitimet nga ligji i pagës minimale janë për një pjesë të caktuar punonjësish që janë më pak produktivë se baza e pagës minimale. Këta njerëz kushtojnë shumë për tu punësuar, ndaj ngelen papunë.

Në të njëjtën mënyrë përfitojnë disa njerëz edhe nga ato ligje që i mbrojnë ata prej pushimit nga puna, por këto i dekurajojnë punëdhënësit që të punësojnë njerëz të rinj. Sa më të rreptë të jenë ligjet e punës, aq më shumë frikë do kenë punëdhënësit se nuk do mund të lëvizin dot nga puna ata njerëz që janë të paaftë ose të tepërt. Rezultati është që ata marrin në punë më pak vetë dhe kjo lëndon më tepër punonjësit me aftësi të ulëta. Nga ana tjetër, papunësia e lartë i bën të aftët ose ata që e kanë një punë, të kenë frikë të ndryshojnë rrugën e karrierës.

Ligjet mbi kontrollin e qirave ju japin përfitime qiramarrësve aktualë, ndërkohë që dekurajojnë qiradhënësit dhe investitorët që duan të zhvillojnë projekte *real astate*. Kështu, ata shpiten në shkurtimin e numrit të shtëpive me qira, duke lënduar njerëzit që kërkojnë një vend për të jetuar.

Nëse marrim ligjet që diktojnë standardet minimale të produkteve dhe shërbimeve, nuk është se prej tyre përfitojnë të gjithë. Këto ligje kufizojnë ofertën, reduktojnë zgjedhjen konsumatore, rrisin çmimet, pra lëndojnë të varfrit. Për shembull, ligjet që mandatojnë standardet e sigurisë për makinat rrisin çmimet dhe i bëjnë ato të papërballueshme për grupet me të ardhura të pakta, që nga ana e tyre ju mohohet të vendosin për veten se çfarë rreziqesh duan të marrin në rrugë.

Për të parë më mirë se rregulla të tillë “mbrojtës” kanë pasoja serioze, imagjinoni sikur qeveria do të ndalonte shitjen e makinave që renditen më poshtë se cilësia e Mercedes Benz-it. A nuk do na siguronte kjo që ne do të ngisnim të gjithë makinat më të sigurt në botë? Por, sigurisht, vetëm ata që do e përballonin blerjen e një Benzi do mund ta bënin. Pyeteni veten: Pse qeveria nuk e trefishon pagën minimale? Do kishim bërë të gjithë plot para, apo jo? Ose të paktën, ata që do kishin një vend pune. Të tjerët jo. Qeveritë nuk bëjnë dot magji me ligjet e tyre, edhe pse shumë njerëz e mendojnë këtë.

Ndonëse askush nuk i merr leje qeverisë për të pirë një birra, aprovimi duhet gjithsesi. Qeveria jonë demokratike mund ta ndalojë fare mirë pirjen e birrës, nëse dëshiron. Kjo gjë ka ndodhur në ShBA. Kështu, për shembull, duhet të jesh 21 vjeç që të lejohesh të pish alkool.

Edhe vendet e tjera demokratike kanë rregulla të ngjashëm. Në Suedi mund të blesh alkool të fortë vetëm në dyqanet shtetërore. Në shumë shtete prostitucioni është i jashtëligjshëm. Norvegjezëve nuk ju lejohej të “blejnë” seks jashtë Norvegjisë. Në Holandë ju duhet leje nga qeveria për të ndërtuar një strehë apo për t’i ndryshuar pamjen shtëpisë tënde. Të gjitha këto janë shembuj të diktaturës, jo të lirisë.

Haset ndonjëherë në demokracitë perëndimore që maxhoranca nuk mund të bëjë çfarë të dojë dhe se demokracitë në fakt mbrojnë të drejtat e “minorancës”. Ky është një mit. Aktualisht ka pak minoranca që gëzojnë “mbrojtje” speciale nga shteti, si lëvizjet feministe, gej, dhe minoritetet etnike. Minoritete të tjera si meksikanët, duhanxhinjtë, përdoruesit e drogës, sipërmarrësit, të pastrehët, Kristianët – nuk mund të përfitojnë këto trajtime speciale. Popullariteti i disa minoriteteve ka të bëjë më tepër me modën se me demokracinë.

Arsyet pse disa minoritete lihen vetëm ose trajtohen me preferencë ndryshon në demokraci. Disa ngrihen menjëherë në këmbë e dalin në rrugë kur të “drejtat” (që nënkupton privilegjet) u shkelen apo kërcënohen, si për shembull sindikatat e punëtorëve apo të fermerëve në Francë. Të tjerë trajtohen me shumë kujdes, sepse është dyshimi se mund të reagojnë me dhunë kur duhet t’i binden ligjit, si huliganët e futbollit ose bandat etnike dhe aktivistët ambientalistë. Nëse duhan pirësit, dikur maxhoritet, do ishin përgjigjur me dhunë kundër ndalimit të duhanit, shumë ligje anti-duhan nuk do ishin miratuar.

Çështja është se nuk ka asgjë në një sistem demokratik apo në parimet e demokracisë që garanton të drejtat e minoriteteve. Parimi themelor i demokracisë është që minoritetet nuk kanë të drejta të patjetërsueshme. Parlamentet dhe Kongresi mund të adoptojnë çdo lloj ligji, pa i marrë në konsideratë minoritetet. Dhe manitë ndryshojnë. Minoriteti i heshtur sot mund të bëhet agresiv, nesër kurban.

Por, a nuk kanë kushtetutë demokracitë që të na mbrojnë nga legjislacioni tiranik i maxhorancës? Deri diku po. Por vëreni që Kushtetuta e ShBA-ve u aprovua para se ShBA-të të ishin demokraci. Dhe kushtetuta mund të ndryshohet nga sistemi demokratik në atë formë që do maxhoranca. Kjo ka ndodhur shpesh. Amendimet kushtetuese tregojnë se kushtetuta i nënshtrohet kontrollit demokratik, që do të thotë, sundimit të maxhorancës. Por as kushtetuta origjinale nuk qe perfekte, sepse lejonte skllavërinë.

Vende të tjera demokratike kanë kushtetuta që janë më pak mbrojtëse ndaj lirive individuale. Sipas Kushtetutës Holandeze, shteti duhet të sigurojë punë, shtëpi, jetesë, kujdes shëndetësor, rishpërndarje të pasurisë etj. Kjo kushtetutë duket më tepër si një program social-demokratik zgjedhjesh se sa një manifest i lirive individuale. Bashkimi Evropian ka një kushtetutë që thotë: “do të punojë për mbështetjen e zhvillimit evropian, bazuar në rritjen e balancuar ekonomike dhe stabilitetin e çmimeve, ekonomi të tregut tepër konkurruese e sociale, duke synuar punësim të plotë e progres social, si dhe nivel të lartë të rrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit.” Ky dhe nene të tjera të kushtetutës i hapin autoriteteve evropiane rrugë të lirë për të rregulluar problemet e njerëzve si të duan. Aksidentalisht, francezët dhe holandezët votuan kundër kësaj kushtetute në referendum, por megjithatë ajo u aprovua.

Shpesh thuhet se demokracia ecën përkrah lirisë së fjalës. Ky përsëri është një mit. Asgjë në demokraci nuk e favorizon lirinë e fjalës, gjë që e zbuloi edhe Sokrati dikur. Vendet demokratike kanë lloj-lloj rregullash që e kufizojnë lirinë e fjalës. Kështu, në Holandë është e ndaluar të ofendosh Mbretëreshën.

Në ShBA, Amendamenti i parë i Kushtetutës garanton lirinë e fjalës, por “me përjashtim të fëlliqësisë, shpifjes, nxitjes për greva, fjalëve luftarake si dhe ngacmimeve, komunikimeve të privileguara, sekreteve tregtare, materialeve të klasifikuara, e drejta e botimit, sjelljeve ushtarake, fjalimeve komerciale si: reklama, dhe kufizimeve në kohë, vend e mënyrë”. Këto janë shumë kufizime.

Kushtetuta amerikane dhe e drejta e fjalës që erdhi me të u adoptua përpara vendosjes së demokracisë. Arsyeja pse njerëzit në demokracitë perëndimore gëzojnë një numër lirish nuk është ngaqë janë demokraci, por sepse kanë tradita klasik-liberale apo libertariane që në shekujt 17-18, pra para se të ktheheshin në demokraci. Shumë njerëz në këto vende nuk duan të heqin dorë nga këto liri, ndonëse shpirti i lirë po zbehet nga përzierja me shpirtin demokratik.

Në pjesë të tjera të botës, njerëzit janë më pak të lidhur me liritë personale. Shumë vende jo perëndimore tregojnë pak respekt për to. Në vendet e demokracive islame si në Pakistan, gratë kanë pak liri; atje nuk ka të drejtë fjale apo feje. Në këto vende fjala demokraci është justifikim që përdoret në vend të fjalës shtypje. Sikur demokracia të prezantohej në monarkitë absolute të Dubait, Katarit apo Kuvajtit, kjo do t'i pakësonte liritë, në vend që t'i shtonte. Palestinezët në Rripin e Gazës në mënyrë demokratike zgjedhën një fundamentalist që nuk e do lirinë, Hamasin. (për ironi, ky rezultat nuk u pranua në atë kohë nga ShBA dhe qeveritë e vendeve perëndimore).

MITI 10 - DEMOKRACIA PROMOVON PAQEN DHE NDIHMON NË LUFTËN NDAJ KORRUPSIONIT

Në arenën ndërkombëtare, shtetet demokratike përcaktohen gjithmonë si pozitive, ndërkohë që të tjerët janë negativë. Në fakt, demokracitë e duan paqen, apo jo? S'është tamam kështu. Shpesh kanë treguar se kanë qenë nxitës të luftës. ShBA-të, demokracia më e fuqishme në botë, kanë qenë iniciator të disa luftërave. Qeveritë amerikane kanë kryer shumë grushte shteti, kanë përmbysur qeveri, mbështetur diktatorë (Mobutu, Suharto, Pinochet, Markos, Somoza, Batista, Shahu i Iranit, Sadam Husein etj), dhe kanë hedhur bomba mbi të civilë të pambrojtur, edhe bomba atomike. Aktualisht, ShBA-të kanë trupa në mbi 700 baza ushtarake në mbi 100 vende dhe harxhojnë aq para për mbrojtjen sa të gjitha vendet e botës së bashku.

Britania demokratike shpiku kampet e përqendrimit në Afrikën e Jugut dhe ishte e para që shtypi opozitën nacionaliste në kolonitë e saj, përmes bombardimeve, duke shkatërruar fshatra të tërë (në Irak në 1920). Perandoria Britanike shtypi gjithashtu shumë revolta për pavarësi në kolonitë e saj, si në Afganistan, Indi e Kenia. Sapo u çlirua nga nazistët, Holanda demokratike shpalli luftë kundër popullit të Indonezisë që donte të fitonte pavarësinë. Franca bëri të njëjtën gjë në Indokinë. Vendet demokratike si Belgjika dhe Franca kanë bërë shumë luftëra të pista në Afrikë (Kongo, Algjeri). Ende ShBA-të po luftojnë në Irak dhe Afganistan, shoqëruar me tortura dhe mijëra viktima të pafajshme.

Variacioni i këtij miti tregon qartë se demokracitë nuk i shpallin luftë njëra-tjetrës. Në 1990, gjatë një vizite në Çekosllovakia, Margaret Thatcher e theksoi këtë fakt (nuk hyjnë në luftë me njëra-tjetrën); po ashtu edhe Bill Clinton në një fjalim të mbajtur në Kongresin Amerikan në 1994 (demokracitë nuk sulmojnë njëra-tjetrën). Kjo nënkupton

se të gjitha luftërat që kanë bërë demokracitë janë të përligjura në një farë mënyre, pasi nuk sulmonin demokracitë e tjera. Pra, nëse e gjithë bota do të qe demokratike, nuk do kishte më luftëra.

Tani është e vërtetë se që nga Lufta e Dytë Botërore, shumë vende perëndimore, që janë edhe demokratike, janë bashkuar në NATO e nuk tregojnë ndonjë tendencë për të sulmuar njëra-tjetrën. Por kjo s'ka të bëjë me demokracinë apo me faktin që demokracitë historikisht kanë qenë të paqta ndaj njëra-tjetrës.

FOTO - Nëse ju nuk vini tek demokracia, Demokracia vjen tek ju.

Në Greqinë e lashtë, qytet-shtetet demokratike luftonin rregullisht kundër njëra-tjetrës. Në vitin 1898, ShBA-të luftuan me Spanjën. Lufta e Parë Botërore u bë kundër Gjermanisë, që s'qe më pak demokratike se Britania apo Franca. Që nga viti 1947, India dhe Pakistani luftuan kundër njëra-tjetrës, ndonëse qiheshin vende demokratike. ShBA-të mbështetën grushte shteti anti-demokratike në Iran, Guatemalë dhe Kili, pavarësisht se qeveritë e këtyre vendeve qenë zgjedhur demokratikisht. Izraeli ka bërë luftë kundër Libanit dhe Gazës që po ashtu janë vende demokratike. Rusia pati konflikte me Gjeorgjinë demokratike së fundmi.

Arsyeja pse vendet perëndimore moderne demokratike nuk i kanë shpallur luftë njëra-tjetrës pas Luftës së Dytë Botërore ka të bëjë me kushte historike mjaft specifike, mbi bazën e të cilave është e vështirë të nxjerrësh konkluzione. Arsyeja më e rëndësishme është se ato janë të lidhura në aleancë ushtarake, në NATO.

Ka dhe një "ligj" tjetër i cili thotë se "dy vende që kanë dyqane McDonald asnjëherë nuk kanë zhvilluar luftë me njëra-tjetrën". Kjo dukej si e drejtë për një kohë të gjatë – deri sa erdhi bombardimi i Serbisë nga NATO në 1999. (Më vonë pasuan edhe dy raste të tjera – sulmi izraelit në Liban dhe konflikti Rusi-Gjeorgji).

Ndonjëri madje argumenton se demokracia ka çuar në intensifikimin e luftërave. Para se demokracitë të bëheshin popullore, deri në shekullin e 18-të, mbretërit luftonin me ushtritë mercenare, nuk kishte rekrutim dhe njerëzit nuk kishin pse luftonin apo urrenin kombe të tjerë.

Me ngritjen e shteteve demokratike-nacionaliste, kjo gjë ndryshoi. Në të gjitha vendet demokratike u fut rekrutimi, duke filluar në Francë me Revolucionin Francez. E gjithë popullsia u mobilizua për të bërë luftëra kundër popujve të tjerë.

Nuk është e drejtë të barazosh demokracinë me nacionalizmin, por këto dy ideologji u bënë në të njëjtën kohë të njohura për një arsye. Demokraci do të thotë qeverisje e "popullit". Patjetër që ky nocion shton tendencat nacionaliste. Me "të drejtat" demokratike vijnë edhe detyrimet demokratike. Ke të drejtë të votosh, por edhe të luftosh për mbrojtjen e vendit tënd.

Të mos harrojmë se Lufta shkatërrimtare e Parë Botërore, e cili hapi rrugën për vendet totalitare të shekullit të njëzetë dhe Luftës së Dytë Botërore, u zhvillua nga vende demokratike ose gjysmë demokratike. Lufta e Parë u bë në Evropë në kohën kur nacionalizmi demokratik e kishte shtyrë pas mendimin klasik liberal.

Në ShBA shtypa për luftëra erdhi nga demokratë progresistë, të cilët filluan të dominonin opinionin publik në fund të shekullit të 19-të. ShBA-të morën pjesë në Luftën e Parë

Botërore nën sloganin e famshëm të Presidentit Uillson “ta bëjmë botën demokratike”. Nëse amerikanët do i kishin mbetur besnikë ideve libertariane, parimeve të pastra të baballarëve themelues të tyre, ShBA nuk do hynte në luftë e lufta do përfundonte pa vendime. Në këtë rast, Aleatët nuk do kishin qenë në gjendje të detyronin barrën e Traktatit të Versajës mbi gjermanët dhe Hitleri mund të mos kishte ardhur kurrë në pushtet. Si rrjedhojë, Lufta e Dytë Botërore dhe Holokausti nuk do të kishin ndodhur.

Demokracia, jo domosdoshmërisht sjell më shumë “transparencë” apo llogaridhënie, siç pretendohet shpesh. Fakti që politikanët duan vota për tu zgjedhur inkurajon korrupsionin. Ata duhet të bëjnë diçka për zgjedhësit e tyre që të fitojnë. Ky lloj korrupsioni është veçanërisht i përhapur në Amerikë, ku politikanët nuk i ndal asgjë për të marrë fonde federale ose programe për shtetin apo distriktin e tyre. Për më tepër, ata janë gurë shahu të organizatave të fuqishme lobiste, që ju japin atyre para për fushatat e shtrenjta elektorale. Plus kësaj, “dyert rrotulluese” të Uashingtonit janë bërë të famshme, me njerëz të fuqishëm që kalojnë nga politika tek biznesi (ose fusha ushtarake) e kthehen prapë mbrapsht pa i vrarë ndërgjegjja.

Vendet e tjera demokratike shfaqin forma të ngjashme të korrupsionit. Në vendet në zhvillim, demokracia ecën dorë për dorë me korrupsionin. E njëjta ndodh edhe në vende të tilla si Rusia, Italia, Franca dhe Greqia. Korrupsioni është i pothuajse i pashmangshëm aty ku shteti ka shumë pushtet, çfarëdo lloj qoftë sistemi politik, dhe kjo sigurisht përfshin edhe demokracinë.

MITI 11 - NJERËZIT MARRIN ATË QË DUAN NË DEMOKRACI

Ideja bazë që ekziston pas demokracisë është se njerëzit marrin atë që duan, ose të paktën, maxhoranca merr atë që do.

Me fjalë të tjera, ne mund të ankohe mi nga rezultatet e sistemit tonë demokratik, por në fund të fundit ne kemi atë që dëshironim, atë që zgjodhëm të gjithë bashkë demokratikisht.

Kjo tingëllon mirë në teori, por realiteti është krejt ndryshe. Për shembull, mund të supozojmë se çdo njeri është në favor të një edukimi më të mirë. Por ne ende nuk po e marrim atë lloj edukimi. Ne kemi sot mësues të kërcënuar, dhunë nëpër shkolla e nxënës që nuk dinë të lexojnë, të shkruajnë e të bëjnë aritmetikë.

Si bëhet e mundur kjo? Nuk ndodh për shkak të mungesës së demokracisë, përkundrazi. Ky është rezultati që tregon se si funksionon sistemi demokratik. Fakti që edukimi menaxhohet përmes sistemit demokratik do të thotë që politikanët dhe burokratët diktojnë se si të organizohet edukimi e se sa para të harxhohen për të. Kjo do të thotë se roli i prindërve, i mësuesve dhe studentëve, të cilët duhet të zgjedhin për veten, është i minimizuar. Ndërhyrjet e shtetit tregojnë se shkollat dhe universitetet janë mbytur me plane, kërkesa, rregulla dhe rregullore nga Departamenti i Edukimit. Burokracia e përkeqëson edukimin.

Kur njerëzit ankohen për cilësinë e edukimit, politikanët përgjigjen me zbatimin e më tepër rregulloreve. Çfarë mund të bëjnë tjetër? Ideja se duhet t’i japin fund ndërhyrjes as që u shkon nëpër mend politikanëve dhe burokratëve. Nëse ndalojnë, kjo do të nënkuptonte se janë jo produktivë apo të sipërfaqshëm, gjë që nuk do e bënin kurrë, pasi nuk është në interesin e tyre.

Rregulloret e reja e përkeqësojnë problemin, sepse e kufizojnë më tepër rolin e studentëve, mësuesve dhe prindërve. Ato çojnë gjithashtu në më tepër burokraci e shpesh krijojnë incentiva perverse. Për shembull, në Holandë shkollave ju kërkua të jepnin një numër minimal orësh, për të rritur kualitetin e mësimit. Por kjo nuk ndikoi tek fakti që shkollat vuanin mungesë mësuesish; kështu shkollat i detyruan të mbanin nxënësit ulur në klasë pa bërë asgjë për orë të tëra. Nuk është habi që qeveria i menaxhon mjaft mirë shifrat. Nga distanca, e vetmja njësi matëse është sasia. Cilësia shihet vetëm nga ata që janë direkt të përfshirë.

Sistemi demokratik mund të krahasohet me fabrikat shtetërore në ish Bashkimin Sovjetik. Ato qenë të kontrolluara dhe menaxhuara mbi bazë numrash. Pavarësisht (ose me mirë për shkak të) vëmendjes që merrnin nga shteti, cilësia e produkteve ishte e dobët. Asnjë veturë komuniste nuk mund të konkurrojë me një model perëndimor. Kjo sepse prodhimi kontrollohej prej burokratëve, jo prej konsumatorëve. Si mund ta dinë burokratët se çfarë duan konsumatorët? Dhe çfarë incentivash kanë ata për të bërë përmirësime?

Planifikimi i centralizuar në Bashkimin Sovjetik solli pak inovacion teknologjik e kulturor. Sa shpikje u bënë në vendet komuniste? Cilësia dhe inovacioni janë rezultate të konkurrencës dhe zgjedhjes dhe jo të planifikimit të centralizuar e ndërhyrjes shtetërore. Nëse kompanitë private duan të mbijetojnë, duhet të konkurrojnë duke ulur çmimet sa të jetë e mundur, ose nëpërmjet inovacionit dhe cilësisë e shërbimeve më të mira. Ndërmarrjet shtetërore nuk i kanë këto incentiva, sepse mbështeten me paratë e qeverisë.

Meqë sistemi ynë edukativ është (pjesërisht) i organizuar përmes sistemit demokratik, ai është produkt shtetëror, duke ngjarë me fabrikat shtetërore të ish Bashkimit Sovjetik. Ky shembull tregon se si demokracia në mënyrë të paevitueshme të çon në një shkallë socializmi. Tregu i lirë nuk operon me procese demokratike. Por, në një kuptim, tregu i lirë është më “demokratik” se demokracia, sepse qytetarët mund të bëjnë zgjedhjet e tyre e nuk lënë qeverinë ta bëjë këtë për ta.

Ajo që zbatohet në edukim përfshin edhe sektorët e tjerë, të cilët janë demokratikisht të kontrolluar, siç është kujdesi shëndetësor dhe kontrolli i krimit. Shumë njerëz kërkojnë mbrojtje më të mirë ndaj krimit, por demokracia nuk ju jep dot gjithçka që ata duan. Njerëzit votojnë politikanët që premtojnë luftë kundër krimit, por rezultati është përherë negativ duke shtuar pasigurinë.

Në Holandë krimi për frymë u rrit gjashtë herë në vitet 1961-2001 dhe çdo vit rreth 700.000 krime të raportuara mbeten të pazgjidhura. Në shumë raste të tilla (të paktën 100.000), policia e di se cili është fajtori, por nuk e ndjekin rastin për shkak të mungesës së kohës apo neglizhencës. Oficerët e policisë duhet të kalojnë shumë kohë me shkresa në zyrë, por e gjejnë kohën për të mbyllur plantacionet e drogës apo për të gjobitur ata që bëjnë shkelje të lehta në trafik.

Performanca e dobët e policisë është rezultati direkt i faktit se është demokratikisht e kontrolluar. Policisë i është dhënë monopoli në zbatimin e ligjit. Gjithsecili e kupton se nëse i jepej ExxonMobile-it monopoli në tregun e naftës, çmimi i gazolinës do të rritej dhe shërbimi do të binte. E njëjta gjë zbatohet edhe tek policia, e cila merr shumë para, pavarësisht se sa i pakët është numri i kriminelëve të kapur. Nëse policia është e suksesshme në pakësimin e krimeve, buxheti i tyre do shkurtohet dhe shumë policë do mbeteshin pa punë. Kjo ndodh me të gjithë organizmat shtetërorë e nuk mund të fajësohen njerëzit që punojnë në to. Vetëm njerëzit më zellshëm e me moral do vepronin ndryshe në kushtet e incentivave perverse të sistemit.

Ndonëse policia nuk arrin të performojë mirë në kapjen e kriminelëve, e kundërta ndodh në plotësimin e formularëve. Gjithkush që ka dëshmuar për ndonjë krim mund ta verifikojë këtë gjë. Nuk i fajësojmë dot as për këtë, pasi janë të bombarduar me rregulla të reja të cilave duhet t'ju përmbahen. Në Holandë, në mbi 7000 oficerë policie shtesë që filluan punë në vitet 2005-2009, vetëm 127 përfunduan aktivë duke e kryer punën në rrugë. Sipas policisë, ky ishte rezultati i ngarkesës së madhe të punës të krijuar nga rregulloret qeveritare.

Për t'i përkeqësuar punët, policia po merr më tepër pushtet. Kjo gjë është e vërtetë në ShBA, pas sulmeve të 11 shtatorit, kur u shtuan kontrollet nëpër aeroporte, u vendosën përgjues telefonikë apo u torturuan terroristët e dyshuar.

A ka alternativë ndaj këtyre detyrimeve? Sigurisht. Alternativa është që individët, bizneset, lagjet, qytetet të kenë më tepër kontroll mbi sigurinë e tyre. Monopoli i policisë duhet t'i hapë rrugë konkurrencës mes firmave të sigurisë. Njerëzit nuk duhen detyruar të paguajnë taksa për policinë qeveritare, por të lejohen të marrin me qira firma sigurie. Kjo gjë do ulë çmimet dhe do rrisë cilësinë. Sot, sektori i sigurisë private po rritet, pasi njerëzit e kanë kuptuar se nuk mund të mbështeten tek policia shtetërore për të qenë të mbrojtur.

Ajo që i ndodh edukimit dhe policisë, është njësoj në të gjithë sektorët publikë. Kontrolli demokratik mbi kujdesin shëndetësor ul cilësinë dhe ngre koston. Nëse ky sektor do bëhej pjesë e tregut të lirë, atëherë do sillte inovacione e përmirësim.

fakti është që njerëzit zakonisht nuk marrin atë që kërkojnë nga demokracia. parimi demokratik "një masë bën për të gjithë", çon në centralizim, burokraci dhe monopolizim (karakteristika këto të socializmit). pashmangshmërisht kjo sjell cilësi të dobët dhe kosto të lartë.

Nëse ju duhen prova që demokracia nuk i përmbush premtimet, merrni parasysh faktin që në çdo zgjedhje, politikanët e pranojnë se qeveria nuk ka punuar mirë e premtojnë se do i ndryshojnë gjërat për mirë kudo – në arsim, siguri, kujdes shëndetësor etj. Por gjithmonë ofrojnë të njëjtat zgjidhje: na jepni më tepër para e pushtet dhe do jua zgjidhim problemet. Kjo nuk ndodh kurrë, pasi problemet shkaktohen pikërisht nga pushteti dhe paraja e të njëjtëve politikanë.

MITI 12 - NE JEMI TË GJITHË DEMOKRATË

Nëse demokracia dështon të sigurojë atë që njerëzit duan, atëherë pse njerëzit e përkrahin atë? A nuk është çdo qytetar që mendon drejt një demokrat, pavarësisht se ndonjëherë ankohet për qeverinë?

E dyta është e debatueshme. Nëse njerëzit besojnë në diçka me të vërtetë, nuk varet nga çfarë ata thonë, por në atë që bëjnë kur kanë një zgjedhje të lirë. Nëse dikush detyrohet të hajë mish pule çdo ditë dhe të thotë se e pëlqen shumë, kjo nuk është shumë bindëse. Nuk vlen më nëse personi është i lirë të zgjedhë të mos hajë vetëm mish pule. E njëjta gjë ndodh edhe në demokraci. Demokracia është e detyrueshme, çdo njeri duhet të marrë pjesë në të – individët, qytetet, rrethet, shtetet – të gjithë duhet t'i binden e asnjë nuk rri dot mënjane. A do lëviznin njerëzit 20 km më tutje në një tjetër qytet, në rast se taksat

atje qenë më të ulëta dhe burokracia më e pakët, edhe sikur të mos lejoheshin të votonin? Shumë vetë do e bënin me dëshirë këtë gjë.

Dikush që është në favor të demokracisë tingëllon si një qytetar i ish Bashkimit Sovjetik që këmbëngul të blejë një Lada edhe kur i ofrohet një Chevrolet apo Volkswagen. Kjo s'ka logjikë. Si qytetari i Bashkimit Sovjetik i cili s'ka shans për të blerë tjetër veç makinës Lada, edhe ne s'kemi zgjedhje përveç demokracisë.

Në fakt, shumë demokratë pa dyshim që do ishin të lumtur t'ju shpëtonin masave që supozohet se kanë zgjedhur përmes votave të tyre. Nëse do kishin zgjedhje, a do ja paguanin me dëshirë qeverisë taksat e sigurimeve shoqërore, kur nuk dihet nëse do ia vlen të në momentin që do dilnin në pension? Sa shërbime qeveritare me cilësi të ulët e tepër të shtrenjta do zgjidhnin ata për të paguar vullnetarisht, nëse do kishin zgjedhje për t'i harxhuar paratë e tyre si të dëshironin?

Ekonomisti amerikan Walter Williams njohu faktin se përgjithësisht ne nuk na pëlqen që vendimet tona individuale të bëhen vendime demokratike. Ai shkroi: "për të qartësuar ofensivën ndaj lirisë që demokracia dhe maxhoranca i bëjnë asaj, pyesni veten se sa vendime të jetës suaj do donit t'i merrnit demokratikisht. Po për makinën që ngisni, ku jetoni, me kë martoheni, nëse hani mish gjeli apo derri për Ditën e Falënderimeve? Nëse këto vendime do merreshin përmes procesit demokratik, personi i zakonshëm do e shihte si një tirani e jo liri personale. A nuk është tirani edhe fakti që procesi demokratik vendos nëse duhet të blimi sigurime shëndetësore apo të hiqni para mënjane për pension? Për veten e për këdo anëmbanë globit, ne duhet të mbrojmë lirinë dhe jo atë demokraci që na ofrojnë parlamentarët, të cilët bëjnë të pamundurën për të rrëmbyer votat e maxhorancës."

Fakti që shumë mbështetës të demokracisë nuk i besojnë me të vërtetë idetë që promovojnë, mund të shihet në sjelljen hipokrite të politikanëve demokratë dhe zyrtarëve qeveritarë, të cilët shpesh nuk e vënë në praktikë atë që predikojnë. Mendoni për politikanët socialistë që kritikojnë pagat e larta të drejtuesve të biznesit e kur dalin në pension bashkohen me korporatat. Ose politikanët që predikojnë bekimet e multi-kulturave, por jetojnë në lagje të të bardhëve dhe i dërgojnë fëmijët në shkolla për të bardhë. Ose politikanët që votojnë pro luftërave por që nuk do i dërgonin kurrë fëmijët e tyre për të luftuar.

Ka arsye të ndryshme pse njerëzit pretendojnë se e mbështesin demokracinë, ndonëse sjellja e tyre tregon të kundërtën. Së pari, është e kuptueshme se njerëzit ja atribuojnë prosperitetin tonë relativ sistemit politik në të cilin ndodhemi. Në jemi në gjendje të mirë e jetojmë në demokraci, pra demokracia duhet të jetë sistem i mirë, kështu vazhdon arsyetimi. Por kjo është e gabuar. Krahasojeni këtë me atë çfarë kanë thënë për Leninin dhe Stalinin disa mbështetës të tyre. Sigurisht, këta diktatorë mund të kenë kryer krime, por njerëzit duhet t'ju jenë mirënjohës pasi nën regjimin e tyre, Bashkimi Sovjetik u industrializua dhe gjithsecili pati mundësinë të kishte dritë elektrike. Por Rusia gjithsesi do ishte industrializuar dhe elektrifikuar në shekullin e 20-të, edhe sikur Lenini e Stalini të mos kishin ekzistuar. Në të njëjtën mënyrë, progresi që kemi bërë në shoqëri nuk mund t'i atribuohet sistemit tonë politik. Shikoni Kinën. Ekonomia kineze ka ecur me hapa gjigandë, por vendi nuk ka demokraci. Prosperiteti bazohet mbi shkallën e lirisë ekonomike që gëzojnë njerëzit dhe sigurisht së të drejtave të tyre mbi pronën, jo mbi shkallën e demokracisë.

Një arsye e dytë pse njerëzit tentojnë të mbështesin sistemin tonë është se e gjejnë të vështirë të imagjinojnë se si mund të qe jeta e tyre nëse do i mbanin të gjitha paratë që do fitonin e s' do kishin pse të paguanin taksa. Ju mund të shihni autostradën publike “falas” kur udhëtoni me makinë, por nuk shihni ndonjë qendër të re shëndetësore që mund të qe ndërtuar me të njëjtat para. As që mund të imagjiloni veten me pushime diku, nëse do ishit detyruar të paguanit për luftën në Irak. Më pak i dukshëm është edhe inovacioni që do ndodhte nëse qeveria nuk do ndërhynte në ekonomi. Në një treg të lirë, shumë trajtime të reja mjekësore që do shpëtonin jetë njerëzish, do arrinin të kryheshin pa dyshim, që ndërkohë ndrydhen prej demokracisë.

Ndonjëherë duket sikur qeveria me magji siguron shumë gjëra falas, por është një çmim i fshehur për tu paguar: të gjitha mundësitë – shërbimet, produktet, inovacionet – nuk janë krijuar sepse mjetet për t'i arritur ato janë uzurpuar nga shteti. Njerëzit shohin vetëm ato që duken mbi kapelën qeveritare, jo ato që fshihen brenda saj.

Ka dhe një arsye të tretë pse ne mendojmë se jemi të gjithë demokratë, kryesisht sepse na e thonë këtë gjë në vazhdimësi. Shkollat, media, politikanët, të gjithë japin mesazhin se e vetmja alternativë e mundshme ndaj demokracisë është diktatura. Duke parë këtë status të saj prej zoti, si mburojë ndaj së keqes, kush do guxonte të dilte kundër demokracisë?

MITI 13 - NUK KA ALTERNATIVË (MË TË MIRË)

Nëse thoni se jeni kundër demokracisë, të gjithë dyshojnë se jeni në favor të diktaturës. Por kjo gjë nuk ka kuptim. Diktatura nuk është e vemja alternativë për demokracinë. Alternativa për të blerë një makinë demokratikisht nuk është një diktator që e ble makinën për ju, por ju që e blini atë për vetë.

Winston Churchill ka thënë: “Demokracia është forma më e keqe e qeverisjes, me përjashtim të të tjerave që janë provuar.” Me fjalë të tjera, demokracia ka të metat e saj, por nuk ka sistem tjetër më të mirë.

Në librin e tij të famshëm “Fundi i historisë dhe njeriu i mbetur” Francis Fukayama shkroi rreth “universalizimit të demokracisë perëndimore liberale, si forma finale e qeverisjes njerëzore.” Presupozohet se nuk mund të ekzistojë diçka më e mirë.

Në këtë mënyrë, çdo kritikë ndaj demokracisë frenohet që në fillim. Supozohet se demokracia qëndron mbi partitë dhe ideologjitë politike, dhe përtej këtij statusi hyjnor asnjë alternativë nuk është e imagjinueshme. Kjo është thjesht propagandë. Demokracia është një formë specifike e organizatës politike. Nuk ka arsye të supozohet se është domosdoshmërisht parimi më i mirë renditur. Ne nuk e përdorim demokracinë në fushën shkencore, ne nuk votojmë për të vërtetat shkencore, por përdorim logjikën dhe faktet, dhe kjo prej arsyes së mirë. Pra s'ka arsye për të supozuar se demokracia është domosdoshmërisht sistemi më i mirë në fushën politike.

Pse njerëzit të mos e organizojnë veten ndryshe nga sistemi komb-shtet në të cilin sundojnë “njerëzit”? Në komunitete më të vogla, për shembull? Por decentralizimi kundërshtohet fort nga sunduesit tanë demokratë e ndonjëherë bëhet i pamundur. Nëse demokracia do të qe kaq sistem i mirë, njerëzve do ju jepej mundësia të hynin apo të dilnin vullnetarisht prej saj. Duke parë “bekimet” që vijnë prej demokracisë, njerëzit do

rrinin në radhë për të hyrë brenda saj. Por nuk është ky rasti. Në asnjë vend demokratik, përfshirë këtu edhe ShBA-të, shtetet apo rajonet nuk lejohen të marrin drejtim tjetër.

Në fakt, trendi në vendet demokratike është krejt e kundërta, drejt një centralizimi më të thellë. Evropa po kthehet në një super shtet demokratik. Me rezultatin e paqartë se tani gjermanët mund të vendosin se si duhet të jetojnë grekët apo e kundërta. Në këtë mega demokraci, disa vende mund të venë barrë mbi rezidentët e vendeve të tjerë si pasojë e politikave të tyre dritëshkurtra ekonomike. Disa vende shpenzojnë para, nuk kursejnë, japin rroga e pensione të majme, krijojnë borxhe të mëdha që nuk do mund t'i shlyejnë dot kurrë dhe arrijnë të bindin vendet e tjera të BE-së që të detyrojnë taksa paguesit e vendeve më të përparuar të paguajnë faturën e tyre. Kjo është logjika e demokracisë në nivelin evropian.

Sa më i madh të jetë shteti demokratik, aq më heterogjene është popullsia, aq më të mëdha janë tensionet që ngrihen. Grupe të ndryshme në shtete të tilla do kenë pak hezitim për të përdorur procesin demokratik për të grabitur dhe për të ndërhyrë tek të tjerët aq më tepër që të munden, për të nxjerrë fitim. Sa më e vogël njësia administrative, aq më homogjene është popullsia, aq më i madh shansi që eksetet e demokracisë të mbeten të kufizuara. Njerëzit që e njohin njeri-tjetrin personalisht ose që e ndjejnë se janë të lidhur, do kenë më pak mundësi të vjedhin apo shtypin njeri-tjetrin.

Për këtë arsye, do ishte ide e mirë t'ju jepje njerëzve mundësinë për “ndarje administrative”. Nëse New Hampshire do lejohej të shkëputej nga ShBA-të, do kishte më tepër liri për t'i organizuar gjërat ndryshe nga Kalifornia, për shembull. Mund të zbatonte sistemin e vet të taksave e mund të qe në favor të sipërmarrësve dhe punonjësve po njësoj. Rajonet do konkurronin me njëri-tjetrin dhe ligjet do viheshin në shërbim të njerëzve. Njerëzit mund të “votonin” me këmbët e tyre, duke shkuar në një tjetër shtet. Qeverisja do bëhej më dinamike e më pak burokratike. Rajonet do mësonin nga njeri-tjetri, sepse mund që secili të eksperimentonte me politika të ndryshme. Mirëqenia për të varfrit, për shembull, mund të organizohej më mirë në nivel lokal. Kontrolli lokal parandalon keqpërdorimin dhe garanton më mirë ndihmën ndaj njerëzve në nevojë që paraja të mos keqpërdoret apo të shkojë dëm. Çmontimi i shtetit të mirëqenies nacional-demokratike është gjithashtu i rëndësishëm për një integrim të suksesshëm të minoriteteve. Tashmë shumë emigrantë jetojnë jashtë këtyre shteteve e askush nuk i do ata. Por shumë njerëz nuk i kanë fare problem emigrantët që janë të zotët të kujdesen për veten e tyre e që kanë dëshirë të përfshihen në jetën e vendit të ri.

Churchill ka thënë gjithashtu: “ Argumenti më i mirë kundër demokracisë është një bisedë pesë minutëshe me një votues të zakonshëm”.

II. KRIZA E DEMOKRACISË

Demokracia mund të ketë nisur si një ideal i madh për të fuqizuar popullin, por pas 150 vjetësh praktikë, rezultatet nuk janë pozitive. Tashmë është e qartë se demokracia është më tepër tiranike se sa forcë çliruese. Demokracitë perëndimore kanë ndjekur rrugën e vendeve socialiste dhe kanë ngecur në vend, janë korrumpuar, burokratizuar e janë bërë shtypëse. Siç jemi përpjekur të tregojmë më sipër, kjo ka ndodhur jo sepse idealet

demokratike ishin shkatërruar, krejt e kundërta, për shkak të trashëgimit të natyrës kolektive të këtij ideali.

Nëse doni të dini se si funksionon në të vërtetë demokracia, marrim një shembull. Papandreu, politikani socialist grek, fitoi zgjedhjet në vend në vitin 2009 me një slogan fare të thjeshtë: Do ketë para! Kundërshtarët e tij konservatorë kishin ulur pagat e punonjësve civilë dhe shpenzime të tjera publike. Papandreu pretendoi se kjo gjë nuk qe e nevojshme. “Lefta Yparchoun!” qe thirrja e tij – Do ketë para!

Ai i fitoi lehtë zgjedhjet, por në realitet para nuk kishte, ose më mirë ato para duhet të nxirreshin prej taksapaguesve në vendet e tjera të Bashkimit Evropian. Por në demokraci, Maxhoranca ka përherë të drejtë dhe kur ata zbulojnë se mund të votojnë pasuri për veten, do e bëjnë atë gjë pashmangshmërisht. Do ishte naivitet të prisnim që të bënim të kundërtën.

Shembulli grek tregon gjithashtu se populli në demokraci i drejtohet shtetit për tu kujdesur për ta. Regjim demokratik do të thotë regjim i shtetit. Si rezultat, njerëzit do vazhdojnë të kërkojnë prej tij. Do bëhen përherë e më të varur nga shteti për të zgjidhur problemet e për të drejtuar jetët e tyre. çfarëdolloj problemi që do hasin, do presin nga qeveria për t’i zgjidhur. Obezitet, abuzim me drogën, papunësi, ulje e numrit të mësuese apo infermierëve, rënie e vizitave në një muze, e plot gjëra të tjera – shteti është aty për t’i zgjidhur të gjitha. çfarëdo gjë që ndodh – një zjarr në teatër, një përplasje avioni etj., – ata presin që qeveria të shkojë pas fajtorëve dhe të sigurojë që asgjë e keqe nuk do ndodhë përsëri. Nëse njerëzit janë pa punë, presin që qeveria t’ju gjejë vende pune; nëse çmimi i gazit rritet, kërkojnë që qeveria të bëjë diçka për këtë. Në YouTube është një video që tregon një intervistë me një grua që sapo ka dëgjuar një fjalim të Presidentit Obama dhe gati po qan nga gëzimi. Ajo thërret: “ Nuk duhet të shqetësohem më për pagesën e gazit për makinën apo për kredinë”. Ky është mentaliteti që ushqen demokracia.

Dhe politikanët janë shumë të dëshiruar të plotësojnë atë që ju kërkojnë njerëzit. Janë si ai njeriu proverbial, i cili ka vetëm një çekiç dhe sheh gjithçka sikur të qe një gozhde për tu ngulur. Në të njëjtën mënyrë, për çdo problem në shoqëri, politikanët e konsiderojnë veten si shpëtimtarë. Për këtë janë zgjedhur, sigurisht. Premtojnë se do krijojnë vende pune, se do reduktojnë normat e interesit, se do shtojnë fuqinë blerëse të njerëzve, se do sigurojnë shtëpi për të pastrehët, do përmirësojnë arsimin, do ndërtojnë sheshe lodrash e kampe sportive për fëmijët e të rinjtë, se do sigurojnë që gjithë produktet dhe vendet e punës janë të sigurta, se do sigurojnë kujdes shëndetësor të mirë e të përbalueshëm për të gjithë, se do çlirojnë rrugët nga trafiku i rënduar, nga krimi e vandalizmi, se do mbrojnë interesat kombëtare në botë, se do zbatojnë ligjet ndërkombëtare në mbarë botën, se do promovojnë emancipimin dhe do luftojnë diskriminimin kudo, se do sigurojnë që ushqimi është i sigurt dhe uji i pastër, se do mbrojnë klimën dhe mjedisin, se do zhdukun urinë nga toka. Do i plotësojnë gjithë ëndrrat dhe kërkesat tona, do na mbrojnë që kur jemi në djep e deri sa të shkojmë në varr, do sigurohen që të jetojmë të lumtur e të kënaqur që nga mëngjesi e deri në darkë – dhe sigurisht se do pakësojnë buxhetin e se do ulin taksat.

Këto janë ëndrrat të cilat bëjnë demokracinë.

MËKATET E DEMOKRACISË

Dihet që realiteti është krejt ndryshe, gjërat nuk funksionojnë kështu. Qeveria nuk mund t'i përmbushë të gjitha këto. Më në fund, politikanët do bëjnë atë gjë që dinë më mirë, që është:

1. Do hedhin para për problemet.
2. Do hartojnë rregulla e ligje të reja.
3. Do krijojnë komitete për të mbikëqyrur zbatimin e tyre.

Si politikanë, s'mund të bëjnë gjë tjetër. As nuk do mund të paguajnë dot faturat për aktivitetet e tyre; edhe këto ju lihen taksapaguesve.

Ne i shohim pasojat e këtij sistemi përditë:

Burokracia. Kudo, demokracitë kanë sjellë shtim të burokracisë, e cila sundon mbi jetët tona me pushtet arbitrar të shtuar. Meqë burokracia vjen prej qeverisë, na sigurojnë se janë mjaft të mbrojtur prej realitetit të ashpër ekonomik me të cilin përballemi të gjithë. departamentet e tyre nuk falimentojnë kurrë, ata vetë nuk pushohen nga puna dhe rrallë ngjallin pakënaqësi ndaj ligjit, meqë janë vetë ligji. Në të njëjtën kohë, na vënë një barrë të rëndë me rregulla e ligje. Kudo bizneset e reja pengohen e dekurajohen nga ligjet dhe kostot burokratike që ju imponohen. Edhe bizneset ekzistuese vuajnë gjithashtu nën peshën e burokracisë. Në ShBA kostot e rregulloreve, sipas Administratës së Biznesit të Vogël, një agjenci qeveritare kjo, janë 1.75 trilion dollarë në vit, sipas një artikulli në Wikipedia. Të varfrit dhe të paarsimuarit vuajnë më tepër nga ky sistem. Ata nuk mund të gjejnë vende pune, sepse janë lënë jashtë tregut nëpërmjet ligjeve të pagës minimale dhe ligjeve të tjera që rrisin kostot e punës. Gjithashtu është e vështirë për ta të ngrenë një biznes të tyre, sepse nuk e gjejnë dot rrugën në xhunglën burokratike.

Parazitizmi. Plus politikanëve dhe burokratëve, ka edhe një grup tjetër që përfitojnë shumë nga sistemi demokratik: ata që drejojnë kompani apo institucione që janë pjellë e qeverisë. Mendoni pak menaxherët e kompanive në fushën ushtarake apo në banka e institucione financiare, por edhe ata që punojnë në sektorët e subvencionuara – institucione kulturore, televizione publike, agjenci ndihmash, grupe ambjentaliste e kështu me radhë. Të mos përmendim këtu gjithë cirkun e “institucioneve ndërkombëtare”. Shumë njerëz kanë vende pune të lakmuara e për këtë i detyrohen qeverisë apo agjencive qeveritare. Kjo është një formë parazitizmi i institucionalizuar, i ndihmuar e i mbështetur nga sistemi ynë demokratik.

Megalomania. Në përpjekje për të fshehur paaftësinë për të ndryshuar vërtet shoqërinë, qeveria rregullisht nxjerr projekte të mëdha për të ndihmuar një sektor industrial që po dështon apo për t'i shërbyer ndonjë kauze tjetër fisnike. Veprime të tilla vetëm sa i shtojnë problemet e kushtojnë më tepër seç planifikohet. Mendoni për sistemin arsimor, planet reformuese të kujdesit shëndetësor, projektet e infrastrukturës dhe energjisë. Edhe luftërat mund të konsiderohen si “projekte publike” të ndërmarra nga qeveria për të shmangur vëmendjen nga problemet kombëtare, për të rritur mbështetjen ndaj qeverisë apo për të krijuar vende pune për të pashkolluarit, por edhe për t'ju shtuar fitimet kompanive të privilegjuara, të cilat nga ana e tyre financojnë fushatat politike të partive

dhe ju sigurojnë vende pune politikanëve që nuk zgjidhen më. (E panevojshme të thuhet se vetë politikanët nuk shkojnë kurrë në luftërat që vetë fillojnë.)

Shteti i ndihmës sociale. Politikanët që caktohen për të luftuar varfërinë dhe pabarazinë natyrshëm e ndjejnë si detyrë të shenjtë prezantimin në mënyrë të vazhdueshme të programeve të reja të mirëqenies (dhe taksave të reja që duhen paguar për këto). Kjo jo vetëm që i shërben interesit të tyre vetjak, por gjithashtu edhe burokratëve në krye të zbatimit të këtyre programeve. Ndihma sociale tashmë merr një pjesë të rëndësishme të shpenzimeve qeveritare në shumë vende demokratike. Në Britani, qeveria shpenzon një të tretën e buxhetit për mirëqenien. Në Itali dhe Francë kjo shifër arrin në 40%. Shumë organizata sociale (sindikata, fonde publike pensionesh, agjenci qeveritare punësimi) kanë interes të mbrojnë dhe shtojnë problemin e mirëqenies. Tipik për mënyrën se si punojnë qeveritë demokratike është fakti se nuk ofrojnë zgjedhje dhe nuk hyjnë në kontrata me qytetarët e vet. Secili detyrohet të paguajë sigurime të larta për papunësinë dhe askush se di se çfarë përfitimesh do gëzojë në të ardhmen. Paratë që ju është dashur të paguanit janë shpenzuar. Kini parasysh se ndihma sociale nuk shkon vetëm tek të pa avantazhuarit, por një pjesë e mirë e saj shkon tek të pasurit, për shembull nëpër bankat që ishin dorëzanë me 700 miliard dollarë (pas së cilës shefat e shpërblyen veten me bonuse të mira).

TABELË - Shteti i zgjeruar i ndihmës sociale

Përqindja e popullsisë që jeton në një ekonomi e që merr disa përfitime qeveritare. (Burimi: Byroja e Regjistrimit, ShBA.)

Sjellja dhe krimi antisocial. Shteti i mirëqenies demokratike inkurajon papërgjegjshmërinë dhe sjelljen antisociale. Në një shoqëri të lirë, njerëzit që sillen keq, dështojnë në mbajtjen e premtimeve ose veprojnë pa pyetur për të tjerët, e humbin shansin e ndihmës së miqve, familjes apo komshinjve.

Megjithatë, shteti ynë i mirëqenies ju thotë: nëse nuk të ndihmon njeri, atëherë të ndihmojmë ne. Kështu njerëzit shpërblehen për sjelljet e tyre antisociale, zhvillojnë mentalitetin e parazitëve që nuk duan të punojnë për të nxjerrë paratë e tyre. Për t'i përkeqësuar gjërat, ligjet e ngurta të punës (si dhe ligjet anti-diskriminuese) e bëjnë më të vështirë për punëdhënësit që t'i heqin qafe ata punonjës që nuk e kryejnë mirë detyrën e tyre. Në mënyrë të ngjashme, ligjet e qeverisë e bëjnë të pamundur të përjashtosh një student apo një mësues që sillen keq apo nuk ka performancë të mirë. Në projektet e strehimit publik është e vështirë të nxjerrësh dikë nga shtëpia e tij, në rastet kur ai person i bezdis komshinjtë. Qeveria shpesh krijon programe të shtrenjta asistence për grupet antisociale, si huliganët në futboll. Kështu pra delinkuentët shpërblehen dhe inkurajohen.

Mediokriteti dhe standardet e ulëta. Meqë shumica në një shoqëri priret ndaj të qenit më e varfër se anëtarët më të suksesshëm e më konkurrues të shoqërisë, ekziston një presion i paevitueshëm mbi politikanët në demokraci për rishpërndarjen e pasurisë – për t'ju marrë të pasurve e për t'ju shpërndarë të varfërve. Në këtë mënyrë, suksesi dhe ekselencia e biznesit dënohet nëpërmjet taksës progresive. Kështu, demokracia mund të

çojë në uljen e standardeve të përgjithshme kulturore. Aty ku sundon maxhoranca, mesatarja kthehet në normë.

Kultura e të pakënaqurit. Mosmarrëveshjet private në mënyrë të vazhdueshme kthehen në konflikte sociale në demokraci. Kjo sepse shteti ndërhyt në të gjitha marrëdhëniet personale e sociale. çdo gjë që shkon keq diku, që nga një shkollë publike e cila funksionon dobët, tek një protestë lokale, kthehet në një çështje kombëtare (ndonjëherë edhe ndërkombëtare), për të cilën politikanët duhet të gjejnë një zgjidhje. Gjithsecili ndjehet i detyruar dhe i inkurajuar të diktojë pikëpamjet e veta mbi të tjerët. Grupe të tilla ngrihen në greva e demonstrata dhe kjo krijon pasiguri e pakënaqësi të përgjithshme.

Termi afatshkurtër. Shtysa kryesore për politikanët në një demokraci është dëshira e tyre për tu rizgjedhur. Prandaj, horizonti i tyre zakonisht nuk shkon përtej zgjedhjeve të ardhshme. Plus kësaj, politikanët e zgjedhur demokratikisht punojnë me burime që s'janë të tyre, por që janë në dispozicion të përkohshëm. Ata shpenzojnë paratë e të tjerëve, pra s'kanë arsye pse të kenë kujdes kur mendojnë për të ardhmen. Për këto arsye, politikat afatshkurtra mbizotërojnë në demokraci. Një ish-ministër i çështjeve Sociale në Holandë ka thënë: "Liderët politikë duhet të qeverisin sikur të mos kishte më zgjedhje. Në këtë mënyrë, ata do jenë në gjendje t'i shohin gjërat në perspektivë afatgjatë." Por kjo është çfarë ata s'e bëjnë dot. Siç e ka thënë edhe autori amerikan Fareed Zakaria në një intervistë: "Mendoj se ne po përballemi me një krizë të vërtetë në botën perëndimore. Ajo që shohim është paaftësia bazë e çdo vendi perëndimor për të imponuar çdo lloj vuajtje afatshkurtër në fitime afatgjata. Sa herë që një qeveri përpiqet të propozojë një lloj vuajtje, ka një revoltë, dhe revolta është pothuajse përherë e suksesshme."

Meqë njerëzit inkurajohen të sillen si parazitë në demokraci dhe politikanët sillen më tepër si qiraxhinj se sa si pronarë, meqë rrallë rrinë në zyrë, rezultati nuk duhet të na habisë. Dikush që merr me qira diçka ka shumë më pak nxitës për të qenë i kujdesshëm me të e për të menduar në afat më të gjatë se sa pronari.

Pse gjërat vazhdojnë të përkeqësohen

Në teori, njerëzit mund të votonin për një sistem të ndryshëm, më pak burokratik e më pak të shpërdorueshëm. Në praktikë, nuk ka gjasa të ndodhë, sepse shumë njerëz shohin interesin dhe kërkojnë ta mbajnë këtë sistem. ndërkohë që qeveria shtohet, edhe ky grup rritet bashkë me të. Siç e ka përcaktuar edhe ekonomisti i madh austriak Ludwig von Mises, burokracia në veçanti do i rezistojë çdo lloj ndryshimi. "Burokrati nuk është vetëm një punonjës i qeverisë", - shkroi Mises. 'Ai është, sipas kushtetutës demokratike, në të njëjtën kohë një votues dhe si i tillë një pjesë e sovranit, punëdhënësit të tij. Ai është në një pozicion të veçantë: edhe punëdhënës, edhe punonjës. Dhe interesi i tij i veçantë si punonjës ngrihet mbi atë të punëdhënësit, sepse ai merr më tepër nga fondet publike se sa kontribuon për to. Kjo marrëdhënie e dyfishtë bëhet më e rëndësishme kur numri i njerëzve në borderonë e qeverisë rritet. Burokrati si votues është më i shtyrë të marrë një rritje se sa të mbajë buxhetin të balancuar. Preokupimi i tij më i madh është të fryjë borderonë".

Ekonomisti Milton Friedman i ndau shpenzimet e parave në katër tipe. I pari është kur i shpenzon paratë e tua për vete. Ke një shtytës për të kërkuar cilësi e për ti harxhuar me efektivitet. Kështu shpenzohen përgjithësisht paratë në sektorin privat. Tipi i dytë është kur i shpenzoni paratë e tua për dikë tjetër. Sigurisht që kujdeseni rreth sasisë që do harxhoni, por jo dhe aq shumë për cilësinë. Tipi i tretë është kur shpenzoni paratë e dikujt tjetër për vete, si për shembull kur hani një drekë me paratë e kompanisë. Në këtë rast keni pak shtysë për të qenë të kursyer, por do bëni përpjekje të hani një drekë të mirë. Tipi i katërt është të shpenzoni paratë e dikujt për dikë tjetër. Atëherë ju s'keni asnjë arsye për tu kujdesur për cilësinë apo koston. Kështu vepron përgjithësisht qeveria me paratë e taksave tuaja.

Politikanët rrallë mbajnë përgjegjësi për masat e marra që kanë zbatuar e që dalin në afat më të gjatë se kanë qenë të dëmshme. Ata marrin famë për qëllimet e tyre të mira dhe rezultatet e para pozitive të programeve të tyre. Pasojat negative afatgjata (për shembull borxhet që duhen për të ri-paguar), do jenë përgjegjësi e atyre që do vinë më pas. Ndaj politikanët kanë pak shtysë për të punuar me programe që do sjellin rezultate pasi ata ta kenë lënë zyrën, sepse kjo do ju njihet si meritë liderëve të ardhshëm.

Kështu qeveritë demokratike shpenzojnë më tepër para se sa marrin. Ato e zgjidhin këtë problem duke ngritur taksat, ose më mirë akoma, meqë njerëzit përherë kanë pakënaqësi ndaj taksave, duke marrë para borxh ose duke emetuar para. (Vini re këtu se paratë i marrin përherë nga banka të preferuara, të cilat pastaj bëhen dorëzanë nga qeveria, nëse hyjnë në borxhe të mëdha). Rrallë e shkurtojnë buxhetin e tyre dhe kur flasin për shkurtime, nënkuptojnë një rritje të ngadaltë të shpenzimeve.

Emetimi i parave sigurisht të çon në inflacion, që nënkupton një rënie konstante të vlerës së kursimeve të njerëzve. Marrja hua e parave shkakton rritje të borxhit kombëtar dhe bën që interesat të paguhen edhe nga brezat e ardhshëm. Aktualisht, borxhet publike të pothuajse gjithë demokracive në botë janë bërë aq të larta sa që s'do kenë kur mundësi të shlyhen. Çfarë është më keq, është fakti s institucionet si fondet e pensioneve, në mënyrë masive i kanë blerë borxhet e qeverisë nën supozimin se ky do ishte një investim i mirë afatgjatë. Kjo është një shaka mizore. Shumë njerëz nuk do i marrin kurrë pensionet e tyre, sepse paratë që kanë vendosur në fondet e pensioneve janë çuar dëm.

Pavarësisht gjithë këtyre problemeve që na sjell demokracia, ne vazhdojmë të shpresojmë e të besojmë se, pas zgjedhjeve të ardhshme, gjithçka do ndryshojë. Kjo na bën të ngecim në një rreth vicioz: sistemi nuk jep atë që premtion, njerëzit zhgënjehen dhe kërkojnë përmirësime, politikanët i shtojnë premtimet e tyre, pritshmëritë rriten më tepër, po ashtu edhe zhgënjimet në fund. Qytetarët në demokraci janë si të dehurit, që kanë nevojë të pinë më tepër për tu intoksikuar, e në të gjitha herët rezultojnë një turbullirë më e madhe. Në vend që të vendosin për t'i qëndruar larg pijes, ata kërkojnë më tepër. Kanë harruar plotësisht se si të kujdesen për veten dhe nuk e kanë më në ngarkim jetën e tyre.

Pse na duhet më pak demokraci

Pyetja është se sa gjatë mund të vazhdojë kjo situatë, duke marrë parasysh pakënaqësinë në shoqëri dhe paqëndrueshmërinë e sistemit politik dhe ekonomik. Shumë njerëz e kuptojnë se ky sistem ka diçka të gabuar. Politikanët dhe udhëheqësit e opinionit vajtojnë fragmentimin e peizazhit politik, paqëndrueshmërinë të elektoratit, sipërfaqshmërinë dhe

ndjeshmërinë e medias. Qytetarët ankohen se politikanët nuk i dëgjojnë, se nuk marrin atë që ju premtohet dhe se Kongresi është një përleshje e qeverisjes së mirë. Megjithatë, ata ja vënë fajin problemeve tek politikanët e gabuar apo çështjeve anësore, si emigrimi apo globalizmi, dhe jo mungesave që trashëgon vetë sistemi demokratik.

Deri tani, asnjë nuk e di në të vërtetë se ku të shkojë që këtej. të gjithë kemi ngecur në vend, në tunelin vizion që quhet demokraci. E vetmja “zgjidhje” që njerëzit mund të mendojnë është “më tepër demokraci”, që do të thotë, më tepër ndërhyrje qeveritare. A pinë të rinjtë më tepër alkool? Atëherë, ngrini moshën e përdorimit të alkoolit. Janë të sëmurët pa kujdesin që kërkohet nëpër spitale? Atëherë, dërgoni më tepër inspektorë. Ka mungese inovacioni? Krijoni një Bord qeveritar inovacioni. A mësojnë fëmijët pak gjëra nëpër shkolla? kërkoni më tepër teste. Janë shtuar krimet? Ngrini një departament qeveritar. Rregulloni me ligj, ndaloni, detyroni, dekurajoni, kontrolloni, inspektoni, reformoni dhe, mbi të gjitha, hidhni më shumë para për zgjidhjen e problemeve.

Po sikur të mos funksionojë e gjitha kjo? Më në fund do dëgjohej e thirrura për një Lider më të Madh, një njeri të fortë që t’i japë fund rrëmujës e të vendos ligjin dhe rendin. Ka një logjikë të caktuar kjo gjë. Nëse gjithçka duhet rregulluar nga shteti, pse të mos e bëjmë siç duhet nëpërmjet një diktatori mirëbërës? Të heqim qafe ngurrimin pa fund, pavendosmërinë, zënkat, jo efikasitetin. Por kjo do jetë leverdi djalli, sepse vërtetë që do kemi ligj e rend, por çmimi do jetë fundi i lirisë, dinamizmit dhe rritjes.

Fatmirësisht, ka një mënyrë tjetër, megjithëse shumë vetë e kanë të vështirë për ta imagjinuar. Kjo është – Më pak Demokraci, Më pak Shtet, Më tepër Liri Individuale.

Se si do jetë ideali libertarian në praktikë, këtë do e shtjellojmë në kapitullin e fundit të librit.

III. DREJT NJË LIRIE TË RE

Do ishte një iluzion të mendonim se problemet me të cilat përballlet shoqëria jonë do zgjidheshin me “më tepër demokraci” ose se demokracia është sistemi më i mirë i mundshëm.

Demokracia u krijua atëherë kur qeveria ishte relativisht e vogël. Por një shekull e gjysmë demokraci ka çuar në ekspansion gjigand të shtetit në të gjithë vendet demokratike; ka çuar gjithashtu në gjendjen kur jo vetëm i frikësohemi shtetit por edhe bashkëqytetarëve tanë, të cilët janë në gjendje të na skllavërojnë nëpërmjet kutive të votimit.

Besimi i verbër në demokracinë e shoqërive tona nuk është i vet-dukshëm. Në fakt është një fenomen i kohëve të fundit dhe mund të habisë shumë lexues. Por baballarët e formimit të shtetit amerikan si: Benjamin Franklin, Thomas Jefferson apo John Smith, qenë pa përjashtim kundër demokracisë.

“Demokracia”, ka thënë Benjamin Franklin, “është dy ujçer dhe një qengj që votojnë se çfarë do hanë për drekë”.

“Liria”, shtoi ai, “është një qengj i armatosur mirë që konteston votën”.

Thomas Jefferson tha se demokracia “është asgjë më tepër se sa sundimi i një turme, ku 51% e njerëzve mund t’ju marrin të drejtat 49% të tjerëve.”

Këta nuk kanë qenë të vetmit. Shumica e liberalëve klasikëve dhe intelektualëve konservatorë të shekullit të 18-19, përfshirë edhe mendimtarët e famshëm si Lord Acton,

Alexis de Tocqueville, Walter Bagehot, Edmund Burke, James Fenimore Cooper, John Stuart Mill dhe Thomas Macaulay, qenë kundër demokracisë. Shkrimtari i famshëm konservator Edmund Burke shkroi: “Jam i sigurt për këtë, se në demokraci maxhoranca e qytetarëve është e aftë të ushtrojë shtypjen më mizore mbi minoritetin...dhe se shtypja ndaj minoritetit do shtohet më tepër e do vazhdojë me më shumë furi, sa që përherë do dominojë një skeptër i vetëm”.

Thomas Macalauy, mendimtari i famshëm liberal britanik shprehu të njëjtin mendim: “Kam kohë që jam i bindur se institucionet demokratike, herët a vonë do e dëmtojnë lirinë, civilizimin ose të dyja bashkë.”

Këto kanë qenë ide të pranueshme në atë kohë, siç e tregon edhe Erik von Kuehnelt-Leddihn në librin e tij “Liri apo barazi” (1951).

Gjatë shekujve të 19-të e 20-të, idealet liberale klasike u vunë në prapaskenë dhe u zëvendësuan me besimin tek kolektivizmi – ku individi është i varur nga grupi. Liberalizmi u zëvendësua me forma të ndryshme të kolektivizmit – komunizmi, socializmi, fashizmi dhe demokracia. Kjo e fundit tani nënkupton idenë e “lirisë”. Por, siç e kemi treguar në këtë libër, është falsitet të barazosh demokracinë me lirinë. Siç e kanë përcaktuar edhe mendimtarët klasikë-liberalë, demokracia është në fakt një formë socialiste. Ajo pak gjë që na ka mbetur nga liria personale është meritë e traditës klasike liberale, e cila është ende e gjallë në perëndim, dhe jo meritë e demokracisë.

Por këto tradita klasik-liberale janë nën presion të vazhdueshëm. Me brezat e rinj që rriten me propagandën e përditshme demokratike që kemi rreth e qark, një pjesë e trashëgimisë sonë liberale po zhduket. Askush nuk habitet më kur gratë kërkojnë kuota në bordet e kompanive, kur shteti ndalon duhanin në pabe ose kur qeveria vendos se çfarë duhet të studiojnë fëmijët tanë nëpër shkolla. Jo të gjithë mund të jemi dakord me këto nocione – por gjithsecilit i duket fare normale që qeveria të vendosë mbi çështje të tilla. Rrallë kundërshtohet fakti se ne jetojmë nën një sistem që ndërhyr në jetët tona deri në detajin më të vogël. Nuk ka opozitë parimore ndaj nocionit se duhet vendosur “demokratikisht” se si duhet të jetojmë.

DECENTRALIZIMI DHE LIRIA INDIVIDUALE

A ka alternativë tjetër ndaj demokracisë? Një shoqëri pa një Shtet absolut, pa sundim maxhoritar, një shoqëri e lirë dhe konkurruese?

Absolutisht që po. Një alternativë e tillë na duhet urgjentisht, nëse nuk duam të biem nën tirani dhe stanjacion. Bota perëndimore ka nevojë për një ideal të ri, një ideal që kombinon dinamizmin dhe lirinë individuale me harmoninë sociale.

Një ideal i tillë nuk është utopik, ai mund të arrihet. Gjëja e parë që duhet bërë është reduktimi i rolit të qeverisë. Njerëzit duhet të rifitojnë kontrollin mbi jetët e tyre dhe frytet e punës së tyre. Pa rregulla dhe taksa ngatërrestare, njerëzit do të krijojnë komunitete të sigurta të jetueshme e të besueshme. Pse të mos i shpenzojnë paratë e tyre si duan, të zgjedhin sigurimin e jetës, atë shëndetësor dhe edukimin që dëshirojnë? Cilat do të qenë pasojat shkatërrimtare që do binin mbi ne, nëse kjo gjë ndodhte? Pse të vendosë shteti për ne? Njerëzve duhet t’ju kthehet liria – të zgjedhin për vete, t’i zgjedhin problemet si ta shohin të arsyeshme, vetë ose së bashku, sepse pa bashkëpunim, rendi dhe

prosperiteti bëhen të pamundura. Por bashkëpunimi mund të funksionojë vërtetë vetëm mbi baza vullnetare dhe me pëlqim reciprok.

Njerëzit duhet të fitojnë kontrollin mbi frytet e punës së tyre. Duhet të kenë liri të krijojnë komunitetet e tyre lokale – fetarë, komunistë, kapitalistë, etnikë, e kështu me radhë. Këto mund të qeverisën “demokratikisht”, nëse rezidentët duan, ose e kundërta nëse nuk duan.

NJË TREG PËR QEVERISJE

Patri Friedman, nipi i laureatit të çmimit Nobel, Milton Friedman, ka thënë: “Qeveria është një sektor me një barrierë shumë të lartë në hyrje. Në fakt, duhet të fitosh zgjedhjet ose të fillosh një revolucion, për të provuar një formë të re qeverisjeje.”

Ka vërtetë shumë pak zgjedhje dhe konkurrencë në qeveri. Njerëzit e konsiderojnë të rëndësishme faktin që kompanitë konkurrojnë, ngaqë presin një treg të lirë fleksibël për makinat, veshjet, sigurimet, treg me furnizues të ndryshëm. Atëherë, pse nuk ka një treg edhe për qeverisjen? Aty ku qeveritë të konkurrojnë dhe ku qytetarët mund të lëvizin lirshëm nga një zonë qeveritare në tjetrën për të punuar e jetuar. Aktualisht, njerëzit mund të shkojnë në një tjetër qytet, por kjo nuk ndryshon asgjë në jetën e tyre, pasi shumica e ligjeve dhe taksave vjen nga qeveria federale. Për të arritur një lloj tjetër qeverisjeje, njerëzit janë të detyruar të emigrojnë, gjë e cila është barrierë tepër e madhe.

Dihet se kompanitë kanë tendencë të formojnë monopole dhe kartelet për të ulur konkurrencën. Por edhe qeveritë e kanë këtë tendencë. Shikoni pak përqendrimin e pushtetit qeveritar në Bruksel dhe Uashington.. Në një treg të lirë, është përherë e mundur që njerëzit të nisnin një biznes të ri, të sfidojnë monopolet dhe kartelet ekzistuese. Ndaj monopolet nuk kanë shumë jetëgjatësi në sektorin privat. Kur monopolistët kërkojnë çmime më të larta ose të abuzojnë me pozicionin e tyre në treg, kjo inkurajon kompanitë e tjera të hyjnë në atë treg të caktuar.

Në qeverisje kjo konkurrencë mungon. Ashtu si monopolistët e vërtetë, politikanët nuk e duan konkurrencën në qeverisje. Preferojnë të vendosin kolektivisht për të gjitha problemet, në nivel qendror. “emigrimi ilegal mund të zgjidhet vetëm në një kontekst evropian”, thonë ata; ose “Terrorizmi mund të luftohet vetëm nëpërmjet një agjencie të fuqishme qendrore”.

Megjithatë, ka vende të vogla në botë që s’janë pjesë e “bloqeve” dhe nuk vuajnë nga kriza apo terrorizmi. Në të njëjtën mënyrë, supozohet të besojmë se edukimi, kujdesi shëndetësor, financat, sigurimet shoqërore e kështu me radhë, duhet të koordinohen dhe rregullohen të paktën në nivel kombëtar. Por nuk ka arsye pse duhet bërë kjo gjë.

Decentralizimi do ishte përfitues për shumë grupe në shoqëri. Me autonomi lokale, mendimtarët progresistë mund t’i vënë në praktikë idetë e tyre progresiste dhe mendimtarët konservatorë mund të bëjnë të njëjtën gjë me vlerat që mbrojnë, pa e detyruar të tjerët të përshtaten me mënyrën e tyre të jetesës. Ata njerëz që duan të krijojnë një komunitet eko-hipish, mund të jetojnë sipas ëndrrave të tyre. Kuptohet që në kurriz të vetë atyre. Një komunitet fetar që dëshiron të mbajë dyqanet mbyllur të dielave, mund ta bëjë këtë gjë. Decentralizimi, ndryshe nga demokracia kombëtare, është një sistem ku “jetohej dhe lihen edhe të tjerët të jetojnë”. Atëherë, lejoni lulëzimin e këtyre mijëra kombeve.

Diversiteti në qeverisje nënkupton që njerëzit mund të vendosin më lehtësisht se nën cilin sistem dëshirojnë të jetojnë e punojnë. Mund të shkojnë fare mirë në një tjetër bashki apo komunë, nëse duan një qeverisje ndryshe. Kjo lloj konkurrence siguron se drejtuesit mbajnë përgjegjësi, sepse do kenë një nxitës shumë të fortë për të përmirësuar politikat e tyre, nëse shohin që njerëzit po ju largohen në një tjetër zonë.

Nëse jo gjithçka përcaktohet nga pushteti qendror, rajonet mund të zgjedhin një drejtim që ju përshtatet kushteve dhe preferencave të tyre. Për shembull, një zonë e caktuar zgjedh të pakësojë taksat dhe ligjet me qëllim që të nxisë aktivitetin ekonomik. Historiani amerikan Thomas E. Woods përcaktoi se liria politike në Evropën Perëndimore u ngrit pikërisht për shkak të fragmentarizmit dhe diferencimit që sundonte aty historikisht. Një mori juridiksionesh të vogla bëri të mundur që njerëzit të zhvendoseshin nga një vend i shtypur në një vend më liberal. Sunduesit tiranikë u detyruan kështu të lejonin më tepër liri individuale.

DECENTRALIZIMI NË ZVICËR

Zvicra ka kohë që ka provuar se decentralizimi mund të funksionojë shumë mirë. Njerëzit shpesh mendojnë se madhësia dhe centralizimi sjellin prosperitet dhe shumë përfitime. Po Zvicra, e cila nuk është anëtare as e BE-së, as e NATO-s, provon të kundërtën. Me gati 8 milion banorë, ky vend ka afërsisht popullsinë e Virxhinia dhe qeverisja e saj është mjaft e decentralizuar. 26 kantone – rrethe – konkurrojnë me njeri-tjetrin dhe gëzojnë mjaft autonomi. Kantonet ishin të ndarë në shtete autonome dikur dhe disa kanë më pak se 50.000 banorë. Ka rreth 2900 bashki në Zvicër – më e vogla ka rreth 30 banorë. Pjesa kryesore e të ardhurave zvicerane nga taksat iu shkon bashkive dhe kantoneve, dhe jo qeverisë federale. Bashkitë dhe kantonet ndryshojnë mjaft në taksim dhe rregullore, pra konkurrojnë në favor të qytetarëve dhe biznesit.

Të gjithë e dimë se Zvicra është një shtet mjaft i suksesshëm. Mban vendet e para për sa i përket jetëgjatësisë, punësimit, mirëqenies dhe prosperitetit. Zvicra është nga të paktat vende në botë që nuk ka parë asnjë luftë në më shumë se një shekull. Pavarësisht ekzistencës së katër gjuhëve (gjermanisht, frëngjisht, italisht dhe romansh), ka shumë harmoni sociale, në kontrast të fortë me situatën në Belgjikë, ku tensionet dhe interesat konfliktuale mes holandezëve që flasin *flemish* dhe francezëve që flasin *walloons*, kërcënojnë shpesh ndarjen e vendit. Ndërkohë që popullsia *flemish* ankohet se duhet të paguajnë për më të varfrit, që janë *walloons*, Zvicra nuk e ka këtë eksperiencë për shkak të decentralizimit.

Sigurisht, Zvicra është një demokraci, por vendi ka kaq shumë njësi më të vogla demokratike, sa që arrin të shmangë shumë efekte negative të demokracisë kombëtare parlamentare.

Zvicra tregon gjithashtu se si mundësia për shkëputje redukton tensionet. Në vitet 70-të banorët frëngjisht folës të kantonit të Bernës nuk u ndjenë të mirë prezantuar në zonën e predominuar nga gjermanisht folës, në të cilën jetonin. Kështu, në 1979 komuniteti frëngjisht folës u shkëput dhe formoi kantonin Jura. Përmes shekujve, mosmarrëveshjet mes grupeve të ndryshme etnike e gjuhësore janë zgjidhur në këtë mënyrë. Meqë kantonet dhe komunitetet zvicerane janë të vogla, njerëzit nuk kanë vetëm të drejtën të

mos votojnë në zgjedhje, por edhe të lëvizin në një tjetër kanton, nëse nuk janë të kënaqur nga qeverisja. Në këtë mënyrë, politikat e këqija zëvendësohen me më të mira.

Kjo s'do të thotë se ne propagandojmë modelin zviceran si idealin ose të vetmin opion. Por ky është një shembull që tregon se si mund të funksionojë një qeveri e decentralizuar, duke çuar në uljen e taksave dhe në më tepër liri individuale. As nuk nënkuptojmë se demokracia është domosdoshmërisht gjë e mirë nëse mbahet e vogël. Edhe një demokraci me tre vetë është e gabuar nëse ata nuk lejohen të largohen prej saj. Mund të ketë të njëjtat efekte negative si një demokraci me 10 milion banorë.

çfarë ka rëndësi, është fakti që njerëzit vetë të lejohen të vendosin se sa e madhe do jetë njësia administrative në të cilën duan të jetojnë dhe çfarë forme qeverisje duan të kenë. Lihtenshteini (160 km²), Monako (2 km²), Dubai, Hong Kongu (1100 km²) dhe Singapori (710 km²) nuk janë demokraci parlamentare. Por janë të suksesshme. Këto vende tregojnë se shpesh “gjërat e vogla” janë të bukura.

Ndonjë mund të mendojë se e drejta për tu shkëputur dhe për tu vet-qeverisur të çon në konflikte, por kjo nuk është e vërtetë. Shikoni se si funksionon tregu i lirë. çdo njeri ka të drejtë të ngrejë një biznes. Por shumica e njerëzve janë të punësuar nga kompanitë. Një bashkëpunim i tillë sjell përfitime për të gjitha palët. Kjo zbatohet edhe për shtetet gjithashtu. Njerëzit mund të zgjedhin të jenë të pavarur, por shumica do e gjejnë në interesin e tyre të futen në shoqëri. Dhe shoqëritë e ndryshme do kenë interes të bashkëpunojnë. Sigurisht, ekonomitë e shkallës mund të reduktojnë kostot, por se në çfarë shkalle do ndodhë kjo mund të përcaktohet vetëm nëse njerëzit janë të lirë të zgjedhin.

Shkëputja nuk të çon domosdoshmërisht në autonomi administrative të menjëhershme. çdo formë decentralizim, në të cilën përgjegjësi të caktuara transferohen nga qeverisja qendrore në atë lokale, mund të quhet shkëputje politike. Kjo mund të jetë një formë tërheqëse (kalimtare) midis shkëputjes dhe situatës aktuale.

Se si do funksionojë kjo gjë mund të shihet në shembullin e të ashtuquajturave Zona Ekonomike Speciale, si Shenzhen që u krijua në Kinë në vitet 1980-të dhe 1990-të. Këto rajone kishin pak rregullore, lejuan disa investime të huaja dhe hapën rrugën për pjesën tjetër të Kinës për të qenë më e lirë. Dubai gjithashtu ka ngritur zona të tregtisë së lirë, ku ekzistojnë pak rregulla tregtie e pune. Zona të tilla të Lira Ekonomike mund të jenë një model Zonat e Lira Politike, ku njerëzit të mund të eksperimentojnë me forma të ndryshme qeverisjeje.

SHOQËRIA KONTRAKTUESE

Njerëzit shpesh mendojnë se, nëse shteti nuk siguron diçka (p.sh. pagesën për opera apo kujdesin për të moshuarit), këto nuk ndodhin. Ky është mentaliteti i njerëzve në ish Bashkimin Sovjetik, që thoshin: “Ku do ishim nëse shteti nuk kujdesej për ne?” Kur ekonomisti amerikan Milton Friedman vizitoi Kinën komuniste, u pyet nga zyrtarët se cili ishte Sekretari Amerikan i Vendburimeve Natyrore. Kur ai ju tha se nuk ekzistonte një pozicion i tillë, ata u habitën së tepërmi. Nuk mund ta imagjinonin se prodhimi dhe shpërndarja e materialeve bazë mund të kryhej pa kontrollin e qeverisë.

Në të shkuarën, njerëzit nuk mund ta imagjinonin se si do të ishte jeta pa një mbret. Mbreti supozohej se do kujdesej për vartësit e tij. Edhe ne sot e konsiderojmë shtetin dhe demokracinë në të njëjtën mënyrë; e kemi të vështirë të imagjinojmë se qytetarët – para vendosjes së demokracisë – pranonin autoritetin e mbretit. Por ata e pranojnë pa kundërshtuar edhe autoritetin e shtetit.

Megjithatë, ne shohim rrotull nesh vetorganizim pa detyrim dhe kontroll nga sipër përditë. Shpesh, ndryshe nga ç’ë presim. Asnjë nuk e mendonte se diçka aq anarkiste sa Wikipedia, enciklopedia e internetit, do ishte e suksesshme pa kontroll qendror. Por funksionoi. I gjithë interneti është një grumbull organizatash, individësh e teknologjish të panumërta e të veçanta që punojnë s bashku pa menaxhim qendror. Në fillimet e Web-it mbarë botëror, shumë vetë nuk mund ta besonin se interneti nuk kishte pronar, se bazohej mbi marrëveshje individuale vullnetare mes mijëra organizatave (sigurues të shërbimeve të internetit, kompani, institucione), secili prej tyre duke kontrolluar një fraksion të vogël të rrjetit.

Në fakt, ideali ynë dhe shoqëria e lirë do të ishin të ngjashëm me modelin në të cilin bazohet interneti. Me internetin, zbatohen vetëm pak rregulla të thjeshtë. Pjesa tjetër është e hapur për këdo për të marrë pjesë aty ku ju duket e përshtatshme. Rregulli kryesor është të komunikojnë përmes protokollit të internetit TCP/IP. Mbi këtë bazë, miliona kompani, organizata dhe individë janë të lirë të bëjnë atë që duan – të krijojnë domain-in e tyre, të ofrojnë shërbimet e tyre dhe të komunikojnë në mënyrën që dëshirojnë. Njerëzit mund të nisin edhe protokolle të reja mbi TCP/IP dhe të zbulojnë nëse të tjerët duan t’i ndjekin. Mund të nisin shërbime të reja e të shohin nëse janë në gjendje të gjejnë klientë. Ky diversitet, liria dhe vet-organizimi në internet ka provuar se funksionon gjithçka shumë mirë.

Në mënyrë të ngjashme, në një shoqëri të lirë, rregulli kryesor nuk është të kryesh mashtrim, dhunë apo vjedhje. Për sa kohë që njerëzit i përmbahen këtij rregulli, ata mund të ofrojnë çdo shërbim, përfshirë edhe ato që tashmë konsiderohen si shërbime “publike”. Mund të krijojnë komunitetet e tyre – monarkist, komunist, konservator, fetar, madje edhe autoritar, për sa kohë “klientët” bashkohen me ta në mënyrë vullnetare e për sa kohë që nuk ndërhyjnë tek të tjerët. Këto komunitete mund të jenë të vogla, deri në 10 vetë, ose të mëdha deri në 1 milion vetë. (Kini parasysh që një kompani private siç është Walmart ka të punësuar 2 milion punonjës).

Kur keni njësi të ndryshme administrative, njerëzit mund të lëvizin, nëse s’ju pëlqejnë gjërat, dhe drejtuesit bëhen të ndërgjegjshëm për këtë. Rezidentët e tyre nuk janë thjesht qytetarë që ju duhet të votojnë herë pas here, por klientë të cilëve duhet t’ju shërbesh mirë për t’i mbajtur si të tillë. E njëjta gjë ndodh në treg. Nëse klientët nuk pëlqejnë atë që ju ofron bukëpjekësi, ata nuk organizojnë protesta për të influencuar pronarin, por shkojnë në një tjetër dyqan buke.

Shoqëritë e vogla kanë më tepër mundësi të mbështeten mbi marrëveshje të qarta se sa mbi influencën përmes kutive të votimit. Në ShBA dhe vende të tjera demokratike, asnjë qytetar nuk ka kontratë me qeverinë, ku të specifikohen detyrimet dypalëshe, për shembull, çfarë qeveria do sigurojë dhe me çfarë kostoje. Mendoni për çështje si pensionet, kujdesi shëndetësor, edukimi, subvencionet, ligjet e punës etj. Qytetarët kanë një detyrim të zbehtë e të papërcaktuar për të paguar taksa e t’i binden ligjit, ndërsa qeveria ka një detyrim të papërcaktuar për të siguruar shërbime. Qeveria mund t’i ndryshojë rregullat në çdo kohë., pavarësisht nga rezultatet e zgjedhjeve. Kjo krijon

pasiguri ligjore të konsiderueshme. Mund të kesh paguar kontribute pensioni prej vitesh me shpresën se kur të dalësh në pension do marrësh një përfitim të caktuar. Por qeveria mund ta ndryshojë shumën e përfitimeve me një të shkruar. Ose ju merrni me qira një dhomë dhe mendoni se mund ta lini kur të doni, kur papritur qeveria vendos kushte të ndryshme zbatimi për kohëzgjatjen e qirasë.

Një shoqëri e mirë duhet të bazohet mbi kontrata ku të drejtat respektohen e të gjitha palët e dinë se ku qëndrojnë. Aty ku rregullat nuk mund të ndryshohen gjatë lojës që bëjnë politikanët. Ato kontrata nuk duhet domosdoshmërisht të jenë njësoj për të gjithë. Si me punonjësit e një kompanie, qytetarë të ndryshëm mund të kenë kontrata të ndryshme, duke u varur nga zona ku jetojnë ose punojnë.

RRUGA DREJT LIRISË

Nëse progresi teknologjik është tregues i zhvillimeve të ardhshme, atëherë perspektivat e demokracisë do ishin të shkëlqyera. Një shpikje teknologjike, si makina, e liroi njerëzit nga lëvizjet. Shpikja e pilulës kundër shtatzënisë ju dha njerëzve më tepër liri seksuale dhe grave më shumë kontroll mbi jetën e tyre. Mbërritja e internetit i dha fund elitës sunduese të medias. tani gjithkush mund të botojë lajme, të dërgojë idetë e tij në botë e të nisë të shesë produkte në internet.

Në fakt, teknologjia është forca e vërtetë demokratizuese, më tepër se vetë sistemi demokratik. Ndërkohë që demokracia i jep pushtet maxhorancës për të sunduar mbi minorancën, teknologjia priret t'i ofrojë individit pushtet mbi jetën e vet. Demokracia ja heq pushtetin mbi veten individit, teknologjia e fuqizon atë. Ka një forcë decentralizuese që mund ta bëjë një njeri apo një qeveri e panevojshme në çështje si komunikim, financë, edukim, media dhe tregti. Meqë tregu i lirë e bën teknologjinë më të lirë, ju jep edhe të varfërve pak kontroll mbi fatin e tyre. Edhe në Afrikë sot miliona njerëz marrin mundësi të reja, jo për shkak të ndihmave për zhvillim, por në sajë të kompjuterave e celularëve që vazhdojnë të liberalizojnë tregun e tyre.

Njerëzimi ka bërë shumë progres gjatë shekullit të fundit, jo prej demokracisë. Pajisje të tilla si iPhone, Walkman dhe PC kanë sjellë avantazhe teknologjike arritshme për individin dhe kanë kontribuar për emancipimin. Përmes shërbimeve të tilla si Facebook, individët mund të zgjedhin vetë kontekstin social të cilit duan t'i përkasin, madje edhe përtej kufijve kombëtarë, pa ndërhyrjen e qeverisë. Plus kësaj, fakti që anglishtja është bërë gjuhë ndërkombëtare dhe mundësia për të udhëtuar lirë e kanë bërë botën “më të vogël” dhe kanë lehtësuar lëvizjet në vende të tjera.

E gjitha kjo nënkupton se konkurrenca në pushtet mund të funksionojë. tashmë njerëzit mund të vendosin ku të jetojnë e punojnë. Miliona prej tyre jetojnë jashtë. Një botë me shumë njësi të vogla qeverisjeje, secila me karakteristikat e saj, do ishte në vijë të drejtë me këto zhvillime. Këto njësi të vogla mund të zgjedhin të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për çështje të caktuara, nëse kjo përbën avantazh për to, p.sh., në energji, emigrim dhe transport. Mund të bashkëpunojnë edhe për mbrojtjen, gjë e cila do marrë rëndësi, nëse një shtet i madh do të shtypë shoqëritë më të vogla. Shoqëritë e suksesshme ekonomikisht dhe ato inovative kanë më tepër mundësi për të gjetur mënyra më inteligjente për tu mbrojtur nga çdo lloj agresioni.

Teknologjitë e reja lejojnë madje edhe krijimin e vendeve të reja. Patri Friedman dhe organizata e tij po përpiqen të ndërtojnë ishuj artificialë në ujërat ndërkombëtare, të cilët mund të sigurojnë alternativa ndaj formave qeverisëse ekzistuese.

Me qëllim që të arrihet decentralizimi, sistemi ynë aktual politik kërkon ndryshime radikale, që nuk janë aq të vështirë për tu realizuar sa mendohet. Organizatat e mëdha qeveritare mund të shpërbëhen. Ministrinë e edukimit, shëndetit, punëve sociale, çështjeve ekonomike, bujqësisë, punëve të jashtme, financave, mund të shpërbëhen. Një shoqëri kërkon vetëm shërbimet publike bazë për të siguruar rend dhe ligj e për tu marrë me problemet e mjedisit.

Shteti i mirëqenies mund të kthehet në një sistem sigurimi privat, që t'ju sigurojë qytetarëve liri e siguri. Ata do mund të paguajnë sigurime në mënyrë individuale apo kolektive përmes sindikatave ose kompanive për të cilat punojnë. Sigurimet që kontrollohen nga shteti përherë pësojnë ndryshime arbitrare. Kjo duhet ndaluar. Kujdesi për të varfrit dhe njerëzit në nevojë mund të sigurohet në mënyrë lokale.

Kontrolli qeveritari sistemit tonë financiar duhet braktisur, me qëllim që qeveritë të mos e zhvlerësojnë më parën tonë. Në këtë mënyrë, do të krijohej një treg ndërkombëtar i drejtë financiar, që nuk do manipulohet më nga qeveritë apo institucionet financiare të lidhura me to.

Shtetet e mëdha demokratike duhet t'i lenë vendin njësitë më të vogla politike, në të cilat qytetarët të zgjedhin se i e duan formën e qeverisë së tyre. Aty ku është e mundur, gjërat duhen diskutuar e vendosur lokalist, në nivele të mundshme sa më të ulëta administrative. Nëse kjo nënkupton fundin e bashkimit Evropian, aq më mirë. Politikanët në Evropë duan ta lurojnë si fundin e botës pamjen e Evropës, nëse Bashkimi do dështonte. Por vende si Norvegjia apo Zvicra, që nuk kanë qenë kurrë pjesë e këtij Bashkimi, po ia dalin mjaft mirë vetë.

Shpesh argumentohet se Bashkimi Evropian siguron tregtinë e lirë mes vendeve evropiane. Nëse kjo do që e vetmja gjë që bënte, do ishte mirë, por ai bën shumë më tepër se kaq. “Tregu i brendshëm” i krijuar në Bruksel nuk ka të bëjë fare me liritë ekonomike. Përkundrazi, Bashkimi Evropian nxjerr ligje dhe rregullore që kufizojnë lirinë ekonomike. Po krijohet një Super shtet, i cili do shkatërrojë lirinë e qytetarëve dhe të biznesit. Bashkimi Evropian përfaqëson të kundërtën e decentralizimit – ai është shembull tipik i centralizimit, një maunë burokratike dembele, ku liritë ekonomike kërcënohen më tepër se në një demokraci kombëtare. Sa më shpejt ta braktisim, aq më mirë do të jetë.

NJË E ARDHME E NDRITUR

E ardhmja duket e ndritur në shumë drejtime. Njerëzimi ka grumbulluar njohuri të pafundme dhe një kapacitet prodhues gjigand, aq sa do të mjaftonte për të krijuar prosperitet për këdo në botë.

Pas rënies së regjimeve fashiste dhe komuniste të shekullit të 20-të, ekziston një trend botëror drejt lirisë. Grupe të mëdha njerëzish kanë fituar më shumë liri personale dhe ekonomike, duke çuar në një mirëqenie dhe prosperitet më të madh. Të tjerët po ngrihen kundër diktaturave duke kërkuar liri. Nuk ka arsye pse ky trend të mos vazhdojë.

Do jetë e vështirë të imagjinohet se jeta është e mundur edhe pa një shtet demokratik, por ndryshime të tilla radikale kanë ndodhur edhe në të shkuarën. Siç shkruanin Linda dhe Morris Tannehill në librin e tyre klasik libertarian anti-demokratik “Tregu për lirinë” (1970): “Imagjiloni një bujkrob feudal, i lidhur ligjërisht me tokën ku ka lindur dhe me pozicionin e tij social, duke u stërmunduar nga agimi në muzg me vegla primitive për të siguruar jetesën, të ardhura të cilat duhet t’i ndajë me pronarin e tij. Imagjiloni sikur t’i flisnit këtij bujkrobi rreth strukturës sociale të Amerikës së shekullit të 20-të. Do vuanit shumë për ta bindur se kjo strukturë mund të ekzistojë, sepse ai do e shohë gjithçka nga këndvështrimi i kohës në të cilën jeton. Pa dyshim që do ju thotë se, nëse individi i lindur brenda një komuniteti nuk do kishte një vend fiks e të përhershëm social në të, atëherë shoqëria do të kthehej shpejt në kaos. Në të njëjtën mënyrë, duke i treguar një njeriu të shekullit të 20-të që qeveria është gjë e keqe, pra e panevojshme dhe se do kishim shoqëri më të mirë pa qeveri, është sikur të nxjerrësh skepticizëm tërë politesë...veçanërisht nëse ai njeri nuk është mësuar të mendojë i pavarur. Përherë është e vështirë të pikturosh në mendje pamjen e një shoqërie ndryshe nga ajo ku jetojmë, sidomos nëse e mendojmë më të avancuar. Kjo sepse jemi mësuar me këto struktura sociale, sa që tentojmë të marrim në konsideratë automatikisht çdo lloj shoqërie më të avancuar duke e shtrembëruar figurën që kemi në mendje e duke e bërë të pakuptimtë”.

Ne besojmë se shteti-komb dhe demokracia që e shoqëron atë janë fenomene të shekullit të 20-të e jo të shekullit 21, kështu që rruga drejt autonomisë dhe fuqizimit do të vazhdojë pa çuar në demokraci më të mëdha, por drejt decentralizimit dhe organizimit të njerëzve në njësi më të vogla administrative, të përcaktuara nga vetë ata.

Disa mund të mendojnë se shumica e njerëzve nuk janë të aftë të jenë të lirë., se nuk e kanë përgjegjësinë apo dëshirën për të jetuar në mënyrë të pavarur, se duhet të drejtohen nga shteti për të mirën e tyre. Ky është i njëjti argument që përdorëm kur folëm për rrëzimin e skllavërisë apo emancipimin e grave. Skllavëria nuk duhej shembur, thuhej atëherë, pasi skllavërit nuk qenë në gjendje të kujdeseshin për veten, kështu që nuk do e dëshironin lirinë. Gratë nuk duhej të kishin të drejta të barabarta, thuhej përsëri, sepse nuk ishin në gjendje të fitonin jetesën e tyre vetë e të përballeshin me kërkesat e një jete të pavarur. Por realiteti vërtetoi të kundërtën. E njëjta gjë do ndodhë edhe kur shteti demokratik të braktiset. Njerëzit do zbulojnë papritur se mund të mbështeten në forcat e tyre sapo t’ju jepet rasti. Sigurisht, nuk do vendosin të jetojnë në mënyrë individualiste, por do organizohen vetë në grupe sipas zgjedhjes së tyre, në kompani, klube, sindikata, shoqata, grupe të veçanta interesi, komunitete apo familje.

Të çliruar nga kontrolli burokratik dhe demokratik i sundimit të maxhorancës, ata do ndryshojnë botën në mënyra që ne mbase nuk i parashikojmë dot tani. Siç e thanë Linda dhe Morris Tannehill: “Shumë situata të padëshirueshme që pranohen pa kushte sot, do të konsiderohen ndryshe në një shoqëri plotësisht të pavarur nga qeveria. Shumë nga këto dallime do krijohen prej një tregu të çliruar nga duart e kontrollit qeveritar, i cili do jetë i aftë të krijojë një ekonomi të shëndetshme dhe standard më të lartë jetesë për këdo.”

Ka ardhur koha që njerëzit të zgjohen e të shohin se demokracia nuk të shpie në liri apo autonomi. Ajo nuk i zgjidh konfliktet dhe nuk i shton produktivitetin apo forcat krijuese. Ndodh krejt e kundërta. Demokracia krijon antagonizëm dhe kufizime. Aspektet centralizuese dhe detyruese të demokracisë rezultojnë në kaos të organizuar, ndërkohë që liria individuale dhe dinamikat e tregut të paorganizuar sjellin rend spontan dhe prosperitet.

Njerëzit do preferonin lirinë para detyrimit, të kishin një zgjedhje direkt të tregut të lirë e jo thjesht ta tregonin preferencën e tyre para kutive të votimit. A do kishte ndonjë njeri, i cili do preferonte që makinën e tij ta zgjidhte qeveria e jo ai vetë?

Njerëzit duhet ta kuptojnë se liria që dëshirojnë për veten, ju duhet dhënë edhe të tjerëve që kjo liri nuk mund të ekzistojë, nëse të tjerët nuk gëzojnë të njëjtën. Përndryshe ata vetë do bëheshin viktimë të pushtetit që ata në mënyrë demokratike do ushtronin mbi të tjerët. Do binin në kurthin e ngritur nga ata vetë. Një lëvizje për më pak demokraci e më shumë liri mund të duket e frikshme për disa. Jemi rritur të gjithë në shtete kombëtare demokratike dhe ju jemi nënshtruar pa fund ideve sociale demokratike. Na kanë mësuar se shoqëria jonë është “më e mira e mundshme në botë”.

Megjithatë, realiteti është më pak tërheqës. Ka ardhur koha që të përballemi me të, pasi qeveria nuk është një Santa Klaus bamirës, por një përbindësh egoist e ndërhyrës që s’kënaqet kurrë e në fund do i marrë frymën pavarësisë dhe autonomisë së subjekteve të saj. Ky përbindësh mbështetet nga demokracia, nga ideja se jeta e çdo qenieje njerëzore mund të kontrollohet nga maxhoranca.

Ka ardhur koha që ideja se populli, pra shteti, ka të drejtën e sundimit, të braktiset. Duhet të heqim dorë nga mendimi se jemi më mirë, nëse vendos qeveria se si të jetojmë e të shpenzojmë paratë tona, se demokracia sjell harmoni dhe prosperitet e se ne vetëm përfitojmë prej saj.

Ka ardhur koha të çlirojmë veten nga tirania e maxhorancës. Nuk kemi se çfarë të humbasim, përveç zinxhirëve që na lidhin fort me njeri-tjetrin.

PASTHËNIE

LIBERTARIANIZMI DHE DEMOKRACIA

Ky libër është shkruar sipas një perspektive libertariane. Libertarianizmi është një filozofi politike që bazohet mbi pronësinë vetjake, që do të thotë të drejtën e çdo individi për të zotëruar trupin dhe jetën e tij, po ashtu edhe frytet e punës së vet. Alternativa ndaj vet-qeverisjes është që disa njerëz sundojnë mbi jetën dhe punën e të tjerëve – ose ajo që është tepër jorealiste – që çdo njeri sundon mbi çdo njeri. Sipas libertarianizmit, një situatë e tillë është e padrejtë, pasi ai bazohet mbi parimin që individët nuk kanë asnjë detyrim për të sakrifikuar veten për kolektivin, siç ndodh në socializëm, fashizëm apo demokraci.

Për libertarianët, liria individuale (vet-pronësia) nuk do të thotë “e drejta” për të punuar, për tu shkolluar, për të pasur kujdes mjekësor, shtëpi apo gjëra si këto, sepse këto “të drejta” nënkuptojnë se është detyrë e të tjerëve që të sigurojnë këto përfitime. Nëse një person detyrohet të sakrifikojë veten për të tjerët, kjo nuk është liri, por skllavëri. Liri do të thotë që gjithsecili ka të drejtën të bëjë çfarë të dojë me jetën dhe pronën e vet, për sa kohë që nuk ndërhyt në jetën dhe pronën e të tjerëve. Pra, libertarianët janë kundër të forcës fizike.

Qëllimi parësor i sistemit libertarian të drejtësisë është mbrojtja e individit ndaj të gjitha llojeve të forcës. Ata janë pro të gjitha lirive që ndjekin parimin e vet-qeverisjes. Për shembull, liria e fesë, vdekja e vullnetshme, fjala e lirë, e kështu me radhë. Jemi

gjithashtu për të drejtën e njerëzve për tu anëtarësuar, bashkëpunuar dhe tregtuar lirshëm, pra për një treg të lirë.

Ne besojmë se individët dhe grupet kanë të drejtën të hartojnë rregullat e tyre në lidhje me përdorimin e pronës që ju përket. Ashtu siç lejohet kushdo të vendosë se kë të ftojë në shtëpinë e vet, edhe pronari i një bari të lejohet të vendosë vetë nëse duhani të pihet ose jo në ambientet e tij; po ashtu edhe punëdhënësi të vendosë vetë në lidhje me kodin e veshjes për kompaninë e tij. Gjithkush të jetë i lirë të mos shkojë në një bar apo të mos punojë për një kompani, nëse nuk i pëlqejnë rregullat e vendosur.

Për këtë arsye, libertarianizmi është kundër ligjeve anti-diskriminim. Ligje të tilla përputhen shumë pak me bashkëveprimin e lirë. Dekreti qeveritar thotë: Duhet të bashkëveproni, edhe po s'ju pëlqeu. Ndryshe, libertarianizmi bazohet mbi lirinë e zgjedhjes – të gjitha marrëdhëniet dhe transaksionet duhet të jenë vullnetare.

Diskriminim do të thotë të trajtohesh ndryshe. Sigurisht, është qesharake të mos duash të shoqërohesh me persona gej, hebrenj, gjermanë e kështu me radhë, por parimi i lirisë nënkupton se askush nuk duhet të justifikojë zgjedhjet e tij, pavarësisht sa qesharake mund të jenë. Nuk ke nevojë për një arsye të fortë që të mos bësh diçka. Libertarianizmi mbron të drejtën e njerëzve për të bërë apo mos bërë gjëra, për të cilat të tjerët mund të mos jenë dakord. Ashtu si për shembull, fjala e lirë nënkupton se njerëzit kanë të drejtën të shprehin një opinion, i cili mund të kundërshtohet prej të tjerëve.

Ligjet anti-diskriminim janë, në fakt, një formë force, sepse i detyrojnë njerëzit të pranojnë diçka kundër vullnetit të tyre. E detyron dot një individ të shoqërohet me dikë që s'e pëlqen? Sigurisht që jo. të detyrosh një punëdhënësi që të punësojë dikë që se do, apo një barist që të pranojë në barin e tij këdo, të gjitha këto forma janë të gabuara dhe jo produktive. Ato të çojnë në urrejtje dhe konflikte, aspak në tolerancë e harmoni.

Libertarianizmi nuk është as i majtë, as i djathtë, as progresiv, as konservator. Progresistët favorizojnë ndërhyrjen qeveritare në ekonomi, por ndonjëherë lejojnë ndonjë shkallë të arsyeshme të lirisë personale. Konservatorët favorizojnë ndërhyrjen qeveritare në zgjedhjet personale, por ndonjëherë lejojnë një shkallë të arsyeshme të lirisë ekonomike. Të përbashkët kanë se të dyja e konsiderojnë individin subjekt të shtetit, të kolektivit.

Libertarianizmi është e vetmja filozofi politike që thotë se kolektivi nuk ka të drejtë të sundojë mbi individin, që është kundër ushtrimit të forcës në parim, pra kundër çdo lloj force përveç vet-mbrojtjes. Bazuar mbi këtë parim, libertarianizmi është gjithashtu kundër kolonializmit, imperializmit dhe ndërhyrjeve të huaja.

Libertarianizmi nuk është një filozofi e re. Ai bazohet në tradita të hershme. Idetë e liberalëve të mëdhenj të shekullit 17-të dhe 18-të qenë shumë pranë idealit libertarian. Sot ne e quajmë filozofinë e tyre si “liberal klasike” për ta dalluar atë nga “liberalizmi” aktual. i cili është më tepër një variant i demokracisë sociale se sa i filozofisë së lirisë. Në shekullin e 19-të, libertarianizmi mbrohej nga një numër anarki- kapitalistë dhe po ashtu edhe nga një grup ekonomistësh klasikë liberalë, kryesisht nga Austria. Një qendër aktuale e libertarianizmit në ShBA është Instituti Mises, që e ka marrë emrin nga ekonomisti i madh austriak i tregut të lirë, Ludwig von Mises. në 1974 Friedrich Hayek, një student i Mises, mori çmimin Nobel në ekonomi. Mendimtari libertarian më i famshëm i shekullit të 20-të ishte një tjetër ish student i Mises, ekonomisti amerikan dhe intelektual gjithëpërfshirës, Murray Rothbard. Libri i tij “Për një liri të re” është ndoshta prezantimi më i mirë i mundshëm i libertarianizmit.

Megjithatë, Mises dhe Rothbard asnjëherë nuk bënë një analizë rigorozë të fenomenit të demokracisë. I pari mendimtar libertarian që e bëri këtë që ekonomisti gjerman Hans-Hermann Hoppe, i cili jetoi dhe punoi në ShBA. Libri i tij “Demokracia – Zoti që dështoi” (2001), është për momentin vepra më standarde libertariane në këtë fushë.

Në vitet e fundit, pjesërisht në sajë të veprës së Hoppe-s, ideja e demokracisë ka marrë më tepër vëmendje nga shkrimtarët libertarianë, por pjesa më e madhe e kritikave të tyre gjendet nëpër artikuj të botuar në revista të ndryshme dhe website libertariane, të tilla si www.mises.org. Me aq sa dimë, asnjë kritikë e plotë libertariane ndaj demokracisë nuk është botuar deri tani. Shpresojmë që me këtë libër të kemi plotësuar këtë boshllëk. Për më tepër informacion rreth librit, shikoni website-in tonë www.beyonddemocracy.net. Në Holandë, më tepër informacion rreth libertarianizmit mund ta gjeni në website-in e Frank Karsten në gjuhën holandisht www.meervrijheid.nl.

DISA THËNIE MBI DEMOKRACINË

“Demokracia është dy ujqër dhe një qengj që votojnë se çfarë të hanë për drekë. Liria është një qengj i armatosur mirë, i cili konteston votën”.

Benjamin Franklin, burrë shteti, shkencëtar, filozof dhe një nga baballarët e themelimit të ShBA-ve.

“Demokracia kurrë nuk zgjat shumë. Shpejt ajo shpërbëhet dhe vret vetveten. Nuk ka pasur kurrë asnjë demokraci që të mos ketë kryer vetëvrasje”.

John Adams, Presidenti i II-të i ShBA-ve.

“Demokracia nuk është asgjë më tepër se sa një sundim turme, ku 51% e popullit mund t’ja heqë të drejtat 49% të pjesës tjetër”.

Thomas Jefferson, Presidenti i III-të i ShBA-ve.

“Besojmë se socializmi dhe demokracia janë një e të pandarë”.

Partia Socialiste, ShBA.

“Çdo zgjedhje elektorale është një ankand më tepër shitjesh të mallrave të vjedhura”.

H.L.Mencken (1880-1956), Gazetar dhe eseist amerikan.

“Si do arrijmë të sigurojmë progres, nëse vazhdojmë të adoptojmë një stil jetese në të cilin asnjë nuk ka dëshirë të marrë përgjegjësi për veten dhe ku çdo njeri kërkon siguri në kolektivizëm? Nëse kjo mani vazhdon, do të biem në një sistem social, ku secili do i ketë duart në xhepin e tjetrit”.

Ludwig Erhart, ish Kancelar gjerman dhe arkitekt i mrekullisë ekonomike të pas-luftës në Gjermani.

“Demokracia e pakufizuar është si oligarkia; një tirani e përhapur mbi një numër të madh njerëzish”.

Aristotle

“Qeveria është një trillim i madh, ku secili përpiqet të jetojë me shpenzimet e tjetrit”.
Frederic Bastiat (1801-1850), teoricien francez klasik liberal dhe ekonomist politik.

“Kur njerëzit zbulojnë se mund të votojnë para për vete, atëherë do të paralajmërojnë fundin e republikës”.

Benjamin Franklin, burrë shteti, shkencëtar, filozof dhe një nga baballarët e themelimit të ShBA-ve.

“Ata që kërkojnë më tepër ndërhyrje qeveritare, përfundimisht kërkojnë më tepër detyrime e më pak liri”.

Ludwig von Mises, ekonomist austriak dhe mbrojtës i madh i tregut të lirë.

“Asnjë jetë njerëzore, liri apo prosperitet nuk janë të sigurta, ndërkohë që legjislatura është në sesion”.

Mark Twain (1835-1910), shkrimtar amerikan.

“Demokracia është vullneti i popullit. Çdo mëngjes habitem kur lexoj nëpër gazeta atë çfarë dua”.

Wim Kan, komedia holandez.

Shtypur në ShBA, Charleston, SC. 12 qershor, 2013.

KAPAKU i Pasmë

“Sapo e mbarova leximin e librit. Fantastik. Punë e shkëlqyer. Përgëzime.” – Hans – Herman Hoppe, autor i librit “Demokracia: Zoti që dështoi.”

Demokracia konsiderohet gjerësisht si sistemi më i mirë politik i imagjinuar. Nuk ekzagjerojmë kur themi se demokracia është bërë një fe laike, besimi më i madh politik mbi tokë. Të kritikosh idealin demokratik është të rrezikosh të të konsiderojnë armik të shoqërisë së civilizuar.

Por kjo është pikërisht çfarë Karel Beckman dhe Frank Karsten propozojnë. Në këtë libër provokativ dhe mjaft të lexueshëm, ata sulmojnë tabunë e fundit politike: idenë se shpëtimi ynë varet nga demokracia.

Me argumente të thjeshta dhe të drejtpërdrejta ata tregojnë se demokracia në kontrast me besimin popullor, nuk të çon në liri, civilizim, prosperitet, paqe dhe sundim të ligjit, por në të kundërtën: në humbje të lirisë, konflikte sociale, shpenzime qeveritare marramendëse, standard të ulët jetese dhe shkelje të të drejtave individuale.

Ata përgënjeshtrojnë 13 mitet e mëdha me të cilat demokracia mbrohet zakonisht. Për më tepër, ata ofrojnë një alternativë tërheqëse: një shoqëri që bazohet mbi lirinë individuale dhe marrëdhëniet shoqërore vullnetare.

A e keni pyetur veten ndonjëherë pse qeveritë zmadhohen dhe po ashtu edhe borxhi publik? Ndërkohë, liria dhe prosperiteti duken më të kërcënuara. Pasi të lexoni këtë libër, do keni gjithçka të qartë – do e dini pse ndodh kjo dhe çfarë mund të bëni më mirë.

Përtej demokracisë është një libër fantastik për këdo që dëshiron të kuptojë më mirë problemet sociale dhe krizën ekonomike aktuale.

THE END